

**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET E
ORGANEVE TË PUSHTETIT VENDOR,
18 SHKURT 2007**

Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) është organizata e parë joqeveritare e krijuar në Shqipëri. U themelua më 19 dhjetor të vitit 1990, si Forumi për Mbrojtjen e Lirive dhe të të Drejtave Themelore të Njeriut dhe është regjistruar me vendimin nr. 17/1 të Ministrisë së Drejtësisë. Më 22 mars 1992, organizata u anëtarësua në Federatën Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, duke marrë edhe emrin që ka sot. Pas miratimit të ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, KShH-ja u regjistrua pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të Tiranës.

Misioni kryesor i KShH-së është:

- *Vëzhgimi* i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.
- *Sensibilizimi* i opinionit publik për të drejtat politike, shoqërore, civile dhe kulturore, për mbrojtjen e tyre dhe për procedurat që duhet të ndiqen në rast se këto të drejta dhunohen.
- *Reagimi* nëpërmjet medias së shkruar dhe elektronike, kontakteve të drejtpërdrejta ose raporteve drejtuar autoriteteteve përkatëse kundrejt shkeljeve të akteve ligjore, të brendshme dhe ndërkombëtare, që i përkasin kësaj sfere, për të vënë në vend të drejtat e dhunuara.
- *Përmirësimi* i legjislacionit dhe i praktikës për zbatimin e ligjit nëpërmjet oponencave dhe rekomandimeve, si në fazën e projektit, ashtu edhe gjatë zbatimit të tyre.
- *Reagimi* për rritjen e përgjegjshmërisë së administratës publike në zbatimin me korrektësi të ligjit dhe për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut.
- *Botimi* i raporteve për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri; i informacioneve në formë fletëpalosjesh, kartash ligjore, broshurash, guidash etj.; i buletineve dhe i raporteve tremujore në dy gjuhë, shqip dhe anglisht.
- *Mirëmbajtja* e një databaze me materiale ligjore për të drejtat e njeriut si dhe të dhëna për shkeljet e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe burgjet dhe komisaritet e policisë, në veçanti.

KShH-ja ka monitoruar të gjitha proceset zgjedhore që janë zhvilluar në Shqipëri. Më 18 shkurt të vitit 2007 ai vlerësoi rëndësinë e zgjedhjeve të zhvilluara dhe ndoqi me kujdes hapat më të rëndësishëm në përgatitjen e ndryshimeve të Kodit zgjedhor, ngritjen e administratës zgjedhore, fushatën elektorale, procesin e votimit si dhe atë të numërimit të votave.

Në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, më 18 shkurt 2007, KShH-ja aktivizoi 150 vëzhgues afatgjatë të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ-së). Ata u trajnuan për Kodin zgjedhor dhe në mënyrë të veçantë për metodologjinë e vëzhgimit.

Objekt i këtij vëzhgimi ishin: shpallja e listave paraprake dhe përfundimtare në afatin e përcaktuar nga ligji, vendosja e tyre në vende publike, interesimi i zgjedhësve për listat, ushtrimi i së drejtës së ankesës ndaj parregullsive në lista, vëzhgimi i elementeve të fushatës elektorale, ngritja e komisioneve të qndrave të votimit dhe trajnimi i anëtarëve të tyre, ngritja e grupeve të numërimit të votave, trajnimi i anëtarëve të këtyre grupeve, heshtja zgjedhore etj.

KShH-ja **monitoroi rreth 650 qendra votimi në rrethet kryesore të vendit¹**. Monitoroi, gjithashtu, **20 qendra të numërimit të votave** në KZQV të përfshira në zonat ku u shtri vëzhgimi.

Falënderime²

KShH-ja falënderon të gjithë vëzhguesit e tij dhe korrespondentët në 7 rrethet më kryesore të vendit për profesionalizmin, paanshmërinë dhe përkushtimin e tyre.

Falënderon, gjithashtu, KQZ-në për akreditimin e shpejtë të vëzhguesve të KShH-së dhe për informimin dhe vënien në dispozicion të udhëzimeve dhe të informacioneve të nevojshme për vëzhgim.

Përsëndet z. Alfred Moisiu, President i Republikës së Shqipërisë, për nismën e ndërmarrë për hartimin e Kodit të etikës për zgjedhjet parlamentare si dhe për vëmendjen e veçantë që i kushtoi rolit të vëzhguesve vendorë.

¹ Bashkinë në Tiranë (njësitë bashkiake nr. 1 - 11), bashkinë e Gjirokastrës, të Elbasanit dhe komunat Bradashesh, Labinot Fushë, Gjergjan, Shirgjan, bashkinë e Fierit, të Durrësit, komunën e Spitalës dhe Shkozetit, bashkinë e Shkodrës, të Vlorës dhe Korçës dhe komunat e Mborjes dhe të Drenovës.

² KSHH-ja përfiton nga rasti të falënderojë CORDAID-in (Catholic Organization for Relief and Development aid) dhe për mundësinë që i krijuan organizatës për të mbështetur kryerjen e vëzhgimeve të zgjedhjeve të organeve të pushtetit vendor, shkurt 2007.

1. Kuadri ligjor dhe reforma zgjedhore

KShH-ja është e mendimit se ecuria e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin dhe sipas standardeve të kërkuara ndikojnë fuqimisht në ushtrimin e së drejtës së votës dhe në realizimin e zgjedhjeve sipas standardeve të kërkuara.

Në 12 janar të 2007-s u arrit marrëveshja midis partive politike, e iniciuar nga Presidenti i Republikës, z.Alfred Moisiu. Më 13 janar 2007 u amenduan një sërë dispozitash të Kodit zgjedhor dhe më 14 janar 2007 u përcaktua data e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore: 18 shkurt 2007.

Parlamenti i Shqipërisë ndryshoi nenin 109, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit mandati i të zgjedhurve lokalë u shty nga 3 në 4 vjet, si dhe nenin 154 të Kushtetutës duke rritur numrin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga 7 në 9 anëtarë.

Gjithashtu, përfaqësimi i partive politike në komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve u rrit nga 7 në 13 persona.

2. Administrata zgjedhore

Miratimi me vonesë i ndryshimeve dhe i plotësimeve në Kodin zgjedhor e vuri KQZ-në në kushte të vështira. Megjithëkëtë KQZ-ja ndërmoi masa që ndihmuan në përgatitjen e aspekteve të ndryshme të zgjedhjeve, si miratimi i disa udhëzimeve. Shqetësim serioz për të ishin: shpallja e listave të zgjedhësve, regjistrimi i partive politike dhe ngritja e KZQV-ve. KShH-ja e ndoqi me vëmendje veprimtarinë e KQZ-së. Në përgjithësi, KQZ-ja punoi në mënyrë profesionale dhe transparente, me përjashtim të rasteve të veçanta të mungesës së etikës dhe të ndonjë qendrimi e prononcimi me elementë politikë. Gjithashtu, nuk na është dukur i drejtë dhe i bazuar vendimi që ai mori për shpalljen e listave të zgjedhësve duke iu referuar për analogji nenit 60 të Kodit zgjedhor ku bëhet fjalë për zgjedhje të pjesshme ose të parakohshme. KQZ-ja ka ndërhyrë për zgjidhjen e shpejtë të mjaft problemeve që kishin të bënin me ecurinë normale të zgjedhjeve, por, në ndonjë rast, kur bllokimi i procesit të numërimit të votave ishte evident³, mendojmë se ndërhyrjet e tij mund të ishin më energjike.

Ngritja e KZQV-ve

³ Për këtë çështje, KShH-ja ka reaguar publikisht, më 19 shkurt 2007. Shih shtojcën nr. 1

Për shkak të ndryshimeve në Kodin zgjedhor, 36 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe shkurtimit të afateve, KZQV-të u ngritën me vonesë⁴. Kjo nuk kishte si të mos ndikonte në ngritjen me vonesë dhe të KQV-ve dhe të grupeve të numërimit të votave si dhe të gjithë procesit të votimit dhe të numërimit.

Vëzhguesit tanë raportuan se në shumë KZQV u vërejt mungesë profesionalizmi dhe njëanshmëri nën ndikimin e partive politike përkatëse.

Anëtarët e komisioneve ishin të patrajnuar ose të trajnuar shumë dobët. Në disa komisione kishte anëtarë që nuk njihnin ligjin dhe procedurat e votimit. Kishte komisione ku anëtarët përpiqeshin të zgjidhnin çështjet me konsensus, pa marrë parasysh kërkesat e ligjit. Në disa raste KQZV-të nuk përgjigjeshin në kohë në zgjidhjen e shqetësimeve ose të problemeve që dilnin.

Pavarësisht nga ato që përmendëm më lart, pati dhe KZQV që punuan me përkushtim dhe që synuan t'i zgjidhnin çështjet në frymën e ligjit dhe me konsensus.

Partitë politike dhe regjistrimi i tyre

Siç dihet, rol tepër të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, në respektimin e së drejtës së votës si dhe në kapërcimin e problemeve dhe të situatave konfliktuale luajnë partitë politike. Regjistrimi i partive politike në KQZ si subjekte zgjedhore, me gjithë kërkesat e vazhdueshme të KQZ-së, u bë me vonesë.

Partitë politike përkatëse, edhe pas krijimit të KZQV-ve kanë tërhequr dhe kanë zëvendësuar anëtarët e propozuar prej tyre. Pasojat e lëvizjeve të tilla kanë qënë të dëmshme, pasi zëvendësuesit e anëtarëve kanë mbetur të patrajnuar.

Partitë politike kanë dërguar me vonesë edhe propozimet e tyre për anëtarë të KQV-ve dhe të grupeve të numërimit të votave. Kjo ka bërë që në shumë njësi zgjedhore, si KQV dhe grupe të numërimit të fillojnë me vonesë procesin e votimit dhe procesin e numërimit në afatin e përcaktuar. Vonesa u vërtetuan edhe në regjistrimin e kandidatëve. Rast flagrant ishte ai i kandidaturës së z. Akile Rama, të Partisë së Ballit Kombëtar, e cila u pranua nga KZQV-ja e Tiranës, por personi vetë nuk kishte dijeni. Meqë kishte të dhëna për falsifikim firme, organet e ndjekjes filluan çështjet penale.

3. Listat e zgjedhësve

Shpallja e listave paraprahe dhe përfundimtare

⁴ Për shpejtimin e kësaj procedure, KSHH-ja u ka bërë thirrje partive politike për të paraqitur në KQZ propozimet për kandidatët e tyre për anëtarë në KZQV, në të kundërtën, kjo do të sillte vonesa në ngritjen dhe trajnimin e tyre dhe do të ndikonte negativisht drejtpërdrejt në procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor. "Vonesat janë shqetësuese", 19 janar 2007

Sipas Kodit zgjedhor të ndryshuar, listat paraprake duhet të ishin shpallur deri në datën 21 janar 2007 dhe zgjedhësit kishin të drejtë të njiheshin me to deri në datën 6 shkurt 2007, ndërsa listat përfundimtare duhet të shpallehin deri në datën 7 shkurt 2007.

Vonesat në shpalljen e listave, si ato paraprake dhe përfundimtare, varionin nga 5 – 9 ditë dhe kjo është vënë re në shumicën e njësisë të qeverisjes vendore që u vëzhguan.

Kjo vonesë çoi në reduktim të kohës së njohjes së zgjedhësve me to dhe, si rrjedhim, vështirësoi mundësinë për t'u ankuar te kryetari i njësisë së qeverisjes vendore si dhe në gjykatë.

Për të ndërgjegjësuar qytetarët, KShH-ja u ka bërë thirrje për të parë listat paraprake me qëllim ushtrimin e së drejtës së votës⁵.

Kërkesë – ankesat drejtuar kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore

Numri i ankesave dhe i kërkesave drejtuar kryetarëve të njësisë së qeverisjes vendore për korrigjimin dhe plotësimin e listave ka qenë relativisht i pakët.

Në shumicën e rasteve, zgjidhja e tyre nuk ka pasur probleme, pasi kanë qenë ngatërime në emër ose mbiemër, datëlindje etj. Në disa raste, njësitë e qeverisjes vendore kanë refuzuar t'u japin vëzhguesve të KShH-së informacione rreth numrit të ankesave.

Listat paraprake dhe ato përfundimtare të zgjedhësve duket se ishin më të plota dhe më të sakta nga ato të zgjedhjeve të mëparshme. Me gjithë përmirësimet e bëra, pati ende probleme, pasi ka pasur qytetarë të cilët janë ankuar për mosgjetje të emrit të tyre në listat paraprake.

Gjatë vëzhgimit, në disa raste, vëzhguesit tanë kanë hasur vështirësi, sepse personeli përgjegjës i bashkive ose i komunave nuk ka qenë në krye të detyrës në orarin e shpallur.

Funksionimi i grupeve dyshe

Sipas ligjit, forcat politike formonin grupe dyshe për verifikimin e emrave në listat paraprake. Nga vëzhgimi dhe nga kontaktet me qytetarët, në disa raste është vënë re që qytetarët nuk janë kontaktuar në mënyrë të rregullt nga grupet dyshe. Kjo është vënë re më masivisht në Vlorë, Durrës si dhe në disa njësi të Tiranës.

Afishimi i listave të zgjedhësve në vende të caktuara

Në përgjithësi, *vendosja e listave paraprake dhe përfundimtare është bërë në vende të dukshme.*

Megjithatë, në disa bashki dhe komuna janë hasur probleme. Në disa zona *listat janë vendosur në mjedise të brendshme të shkollave, kopshteve, lokaleve private, postës etj., të cilat nuk mund të shiheshin gjatë gjithë ditës ose, në pjesën më të madhe të saj, kanë*

⁵ Shih në shtojcën nr. 1, deklaratën publike “Thirrje zgjedhësve! Listat paraprake dhe përfundimtare të zgjedhësve mund të ndryshojnë”, datë 2 shkurt 2007. Në disa organe shtypi, veç emisioneve direkte televizive, për këtë qëllim si dhe për njohjen e zgjedhësve me Kodin zgjedhor, u botuan suplemente të veçanta të përgatitura nga KShH-ja.

qendruar të mbyllura duke u mohuar votuesve të drejtën e verifikimit të emrave në listë. Kjo situatë është hasur në shumë bashki dhe komuna të rretheve Tiranë, Vlorë, Fier, Durrës etj.

Ka pasur edhe raste kur *listat paraprake dhe përfundimtare janë shpallur në vende të papërshtatshme, të vendosura në lartësi dhe distanca të mëdha dhe kjo vështirësonte leximin e tyre nga zgjedhësit. U konstatuan, gjithashtu, raste të grisjes së tyre ose të ndryshimit të vendeve ku ishin shpallur më parë.*

Kërkesat dhe vendimet në gjykatë

Në gjykatat e rretheve të vëzhguara janë bërë kërkesë-ankesa për ushtrimin e së drejtës së votës nga qytetarët të cilët nuk gjenin emrin e tyre në listë. Numri i kërkesave që gjykatat kanë shqyrtuar në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007, krahasuar me atë në zgjedhjet e 3 korrikut të 2005-s, ishte më i vogël.

Regjistri i posaçëm dhe certifikatat

Me ndryshimin e dispozitave ligjore të Kodit zgjedhor, u bënë ndryshime dhe shtesa të dispozitave për lëshimin, përdorimin dhe administrimin e certifikatave të lindjes, si mjet identifikues alternativ për ushtrimin e së drejtës së votës nga qytetarët.

Por përdorimi i këtij regjistri ishte një shqetësim që u has gjatë ditës së votimit. Sipas nenit 181/2, pika 2, të Kodit zgjedhor, jo më vonë se 24 orë para datës së zgjedhjeve, zyra e gjendjes civile duhet t'i dërgojë KZQV-së së njësisë vendore përkatëse kopje të regjistrit të posaçëm të vulosur me vulë dhe të nënshkruar nga drejtues të zyrës së gjendjes civile për certifikatat e lëshuara nga çasti i krijimit të regjistrimit të posaçëm të gjendjes civile deri një ditë para datës së zgjedhjeve. Jo më vonë se 12 orë përpara fillimit të votimit, KZQV-të i shpërndanë çdo KQV-je të njësisë përkatëse zgjedhore kopje të lëshuara nga zyra e gjendjes civile. Në të vërtetë, në shumë qendra votimi në Korçë, Elbasan, Tiranë, Durrës, Vlorë, ky regjistër mbërriti me vonesë, pasi ishte hapur qendra e votimit. Edhe përdorimi i tij, shpeshherë shkaktonte konflikte mes kryetarit dhe nënkryetarit për mospërputhje të emrit në dokumente dhe në atë të listës.

Ndryshimet ligjore për certifikatat u përcaktuan në një dispozitë kalimtare e cila parashikonte rregulla të veçanta. Numrat e serisë të certifikatave të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile pas datës 1 nëntor 2006 duhet të shënoheshin në një regjistër të posaçëm. Një kopje e këtij regjistri do t'u shkonte të gjitha KZQV-ve, të cilat do t'ua shpërndanin KQV-ve për të verifikuar votuesit që do të paraqiteshin me certifikatat e lëshuara pas datës 1 nëntor 2006. Gjatë votimit, kopje të këtyre certifikatave ose origjinali i tyre do të mbahej nga komisioni i qendrave të votimit.

Ndërsa për personat që paraqiteshin me certifikata të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile para datës 1 nëntor 2006, duhet të lejoheshin për të votuar duke paraqitur edhe 2 dokumente të

tjera shtesë, siç mund të ishin: pasaportë me fotografi të padëmtuar, së cilës i ka kaluar afati ligjor i përdorimit; leje të dixhitalizuar për drejtim automjeti; diplomë origjinale të shkollës së lartë ose të mesme, me fotografi të padëmtuar; dokument për pasurinë e paluajtshme të tij, lëshuar nga një zyrë noteriale në bashkinë përkatëse; licencë për ushtrim profesioni privat, me fotografi, lëshuar nga viti 2000 e në vazhdim nga organi tatimor i njësisë vendore ku zgjedhësi ka emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve; certifikatë tatimore, e pajisur me fotografi, e lëshuar nga viti 2000 e në vazhdim nga organi tatimor ku zgjedhësi ka emrin në listën përfundimtare të zgjedhësve; librezë notash e studentëve aktualë.

Kjo procedurë ishte e ndërlikur dhe zbatimi i saj u shoqërua me disa vështirësi, si për zgjedhësit edhe për KQV-të.

Për sensibilizimin e votuesve lidhur me rregullat e reja të certifikatave u punua pak. KShH-ja përgatiti fletëpalosje dhe zhvilloi disa programe televizive, por kjo përpjekje nuk ishte e mjaftueshme.

4. Fushata zgjedhore

Situata e përgjithshme

Sipas nenit 133 të Kodit zgjedhor, fushata elektorale duhet të fillonte 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, pra, konkretisht, në datën 18 janar 2007. Në të vërtetë pati parti që e filluan më parë fushatën elektorale.

Fryma e fushatës zgjedhore ishte relativisht e qetë. Në të gjitha zonat e monitoruara nga KShH-ja nuk u vërejtën pengesa.

Elemente me rëndësi të fushatës elektorale ishin; *posterat, debatet televizive, shpalosja e programeve dhe e alternativave nëpërmjet emisioneve të ndryshme televizive si dhe krijimi i lehtësirave të vendosjes së tyre.* Në përgjithësi, posterat u vendosën jo në vendet e caktuara nga organet e qeverisjes vendore. Shumë prej posterave të vendosur në vende të papërshtatshme u grisën, gjë që u vu re në mjaft njësi zgjedhore të vëzhguara. Kjo ndikoi në acarimin e atmosferës së fushatës zgjedhore si dhe për incidente mes mbështetësve të kandidatëve.

Kodi i etikës zgjedhore

Presidenti i Republikës, z.Alfred Moisiu, ndërmori një hap të rëndësishëm. Ashtu si edhe para zgjedhjeve të 2005-s, ai rekomandoi zbatimin e Kodit të etikës zgjedhore që u firmos nga të gjitha partitë. Madje, për monitorimin e këtij kodi, Presidenti organizoi edhe tryeza me përfaqësues të organizatave vëzhguese vendore.

Për këtë qëllim organizatat vendore monitoruan respektimin e Kodit të etikës, duke e bërë atë publik nëpërmjet deklaratave të përbashkëta si dhe konferencave për shtyp⁶.

⁶ Shih përfundimet e vërejtura për respektimin e Kodit të sjelljes dhe Kodit zgjedhor nga organizatat vendëse, vëzhguese të zgjedhjeve të 18 shkurtit.

Gjuha e kandidatëve në mbledhje, në mitingje ose në aktivitete të tjera të përfaqësuesve partiakë ka qenë kryesisht e ekulibruar, megjithatë ka pasur edhe raste kur është përdorur gjuha e urrejtjes. Kjo është vënë re edhe në spotet reklamuese të kandidatëve, të cilët kanë përdorur kryesisht efektin e antireklamës, duke nxjerrë anë të dobëta të kandidatit tjetër, madje, në disa raste, duke prekur edhe elemente të jetës personale të njërit ose tjetrit kandidat.

Gjatë gjithë procesit u vu re se *vullneti politik linte shumë për të dëshiruar*. Ai vërtet nuk mund të jetë shkopi magjik për zgjidhjen e çështjeve, por, nga ana tjetër, me shkelje të ligjit nuk mund të arrihet ose të kërkohen zgjedhje të lira dhe të ndershme brenda standardeve ndërkombëtare.

Heshtja zgjedhore

Sipas Kodit zgjedhor, 24 orë para fillimit të procesit të votimit fillon heshtja zgjedhore. Kjo kërkesë e ligjit në përgjithësi u zbatua. Gjithashtu, në nenin 134 të Kodit zgjedhor thuhet se rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve. Kjo dispozitë e Kodit zgjedhor nuk u respektua, pasi, më 14 shkurt, 4 ditë para datës së zgjedhjeve, “Tema” dhe “Shekulli” botuan dy lloje sondazhesh për rezultatin e zgjedhjeve. Për këtë shkelje KShH-ja reagoi nëpërmjet një deklaratë publike⁷.

Transparenca financiare e fushatës zgjedhore

Nga fillimi i fushatës dhe deri në datën 16 shkurt 2007 tërhoqi vëmendjen fakti i shpenzimeve të shumta të fushatës. Sigurisht, nuk është detyra jonë të llogaritim sa shpenzime janë bërë nga pozita dhe sa nga opozita ose në çfarë mase janë tejkaluar ato në krahasim me sasi të caktuara nga KQZ-ja, por, duke pasur parasysh se edhe në zgjedhjet e mëparshme nuk është bërë transparenca e duhur, siç kërkon ligji dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, kjo e bën të domosdoshëm zbatimin rigoroz të ligjit.

5. Ngritja e qendrave të votimit

Ngritja e komisioneve të qendrave të votimit dhe trajnimi i tyre

Komisionet e qendrave të votimit (KQV-të) duhej të ngriheshin deri në datën 8 shkurt 2007, por, nga vëzhgimet e kryera, u vu re se në shumicën e njësive të qeverisjes vendore ato nuk ishin ngritur brenda këtij afati. Në datën 12 shkurt 2007, KQZ-ja tërhoqi vëmendjen për këtë fakt. Edhe KShH-ja, nëpërmjet një deklaratë për shtyp, disa ditë përpara ngritjes së tyre bëri thirrje për ngritjen e komisioneve të qendrave të votimit⁸.

⁷ Shih për më shumë deklaratën në shtojcën nr.1 “Të respektohet Kodi zgjedhor”, datë 14 shkurt 2007.

⁸ Shih për më shumë deklaratën në shtojcën nr.1 “Ngritja me vonesë e komisioneve të qendrave të votimit – mund të cenohet të drejtën e shtetasve për të votuar”, datë 5 shkurt 2007.

Në të gjithë vendin duhet të ngriheshin 4721 qendra votimi që do të përbëheshin nga 66094 anëtarë dhe sekretarë të këtyre komisioneve.

Sipas udhëzimit të KQZ-së, datë 18.1.2007, subjektet zgjedhore përkatëse duhet të paraqesin propozimet e tyre për këto grupe pune në KQV-të 10 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, por propozimet e partive politike shkuan me shumë vonesë dhe afati i paraqitjes së tyre nuk është respektuar, madje në disa njësi bashkiake KQV-të u ngritën vetëm 1 ditë përpara ditës së votimit ose gjatë orëve të para të mëngjesit të 18 shkurtit 2007 (Elbasan), duke u bërë kështu pengesë për vonesat në procesin e votimit si dhe për mostrajnimin e komisionerëve. Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve u zhvillua në datat 12 – 14 shkurt 2007.

Ngritja e grupeve të numërimit dhe trajnimi i tyre⁹

Sipas ligjit, grupet e numërimit duhej të ngriheshin 48 orë përpara ditës së zgjedhjeve, por, bazuar në vëzhgimet e kryera nga KShH-ja, ky afat nuk u respektua. Në shumicën e rasteve, grupet e numërimit u ngritën gjatë orëve të paradites së datës 18 shkurt 2007. Kishte edhe grupe që u ngritën disa orë përpara mbarimit të procesit të votimi. Trajnimi i tyre ose ishte formal, ose ata nuk arritën të njiheshin as me kërkesat minimale të ligjit.

Pengesë për ngritjen e tyre ishte paraqitja me shumë vonesë e propozimeve nga partitë përkatëse politike.

6. Situata e përgjithshme e zhvillimit të zgjedhjeve

Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerësoi situatën në përgjithësi të qetë të zhvillimit të procesit të votimit në zonat e vëzhguara prej tij. Pavarësisht nga kjo, gjatë procesit parazgjedhor dhe procesit të votimit janë shënuar edhe disa raste të incidenteve midis kandidatëve dhe simpatizantëve të partive politike.

KShH-ja ka reaguar kundër disa incidenteve që kanë ndodhur gjatë fushatës. *Incidente të tilla kanë ndikuar shpeshherë në acarimin e situatës politike dhe që, në disa raste, janë shoqëruar me pasoja të dëmshme¹⁰.*

KShH-ja shpreh vlerësimet e tij për pjesëmarrjen e votuesve në votime dhe mirëkuptimin e treguar lidhur me vonesat dhe disa probleme të tjera të vëna re në fillimin dhe zhvillimin e procesit të votimit. Me gjithë procedurën e ndërlikuar lidhur me certifikatat e lindjes, të lëshuara para dhe pas datës 1 nëntor 2007, verifikimin krahasues së tyre me regjistrin e posaçëm, në përgjithësi zgjedhësit kanë treguar durim dhe mirëkuptim.

⁹ KShH-ja ka reaguar nëpërmjet një deklarate “Kur do të ngrihen dhe kur do të trajnohen grupet e numërimit të votave?!” datë 24 qershor 2005 si dhe deklaratës “Edhe njëherë për grupet e numërimit të votave”, datë 6 qershor 2005.

¹⁰ Shih në shtojcën nr. 1, deklaratën e datës 12.2.2007.

7. Policia e Shtetit

KShH-ja vlerëson rolin e policisë para dhe gjatë ditës së votimit, në transferimin e kutive të votimit për në qendrat e numërit të votave dhe gjatë procesit të numërimit të votave.

Ajo ka ndërhyrë vetëm në bazë të vendimeve të marra nga komisionet zgjedhore. Në vendet e vëzhguara nga KShH-ja nuk u vërejtën raste njëanshmërie ose ndërhyrjesh arbitrare nga ana e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit, në bashkëpunim me misionin e PAMECA-s, ka organizuar një sërë aktiviteteve koordinuese edhe me OJF-të që vëzhguan procesin zgjedhor.

9. PROCESI I VOTIMIT

▪ *Komisioni i qendrave të votimit dhe hapja në kohë e qendrës së votimit*

Jo të gjithë anëtarët e KQV-së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë qenë të pranishëm në orën e caktuar për fillimin e përgatitjeve paraprake për votim. Kjo është hasur në shumë qendra votimi në të gjitha rrethet, kryesisht në Tiranë, Durrës. Shumica e qendrave të votimit në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë, Fier dhe Gjirokastrë u hapën me vonesë, vonesa që, në disa vende, zgjatën zgjatën rreth gjysmë ore, ndërsa në disa qendra të tjera, si në Elbasan, disa orë. Edhe gjatë ditës së votimit ka vazhduar ndërrimi i komisionerëve nga subjektet politike. Mosardhja e autorizimeve të miratimit të tyre, ndërrimi i tyre i herëpashershëm, ardhja me vonesë në qendrën e votimit të komisionerëve, ka sjellë vonesa në fillimin e votimit. Kjo ka ndodhur në disa QV në Durrës, Tiranë, Elbasan etj. Gjithashtu, ka pasur mungesa të anëtarëve të komisionit. Si rrjedhim, në disa raste, votimi ka filluar edhe kur nuk kanë qenë të pranishëm 13 anëtarët e KQV-ve

▪ *Gjendja e qendrës së votimit*

Në përgjithësi, në të gjitha qendrat e votimit, komisionet e qendrave të votimit kishin afishuar udhëzimet e votimit në një vend të përshtatshëm, me përjashtim të disa qendrave të votimit, si në Gjirokastrë etj. Në të gjitha qendrat, materialet e marra në dorëzim u kontrolluan, me përjashtim të ndonjë rasti sporadik ku anëtarët e komisionit neglizhuan.

Vëzhguesit konstatuan se në mjaft qendra votimi dhomat e fshehta ishin vendosur në mënyrë të tillë që komprometonin fshehtësinë e votës. Zgjedhësit në Tiranë kishin vështirësi për të dalluar kutitë përkatëse ku duhet të hidhnin fletën e votimit.

Ka pasur ngatërresa të vulave dhe të materialeve të tjera zgjedhore. Në përgjithësi, kutitë e votimit janë vulosur me kodet e sigurisë dhe për to është mbajtur procesverbali përkatës.

▪ *Materialet propagandistike*

Vëzhguesit e KShH-së vunë re se pranë disa qendrave votimi deri në largësinë prej 150 metrash kishte pasur materiale propagandistike, postera të kandidatëve dhe të partive, të cilat, pas vërejtjeve të vëzhguesve të KShH-së, në disa raste u hoqën, ndërsa ka pasur edhe raste kur nuk janë hequr¹¹, si p.sh., në Elbasan, Vlorë, Durrës etj.

Në raste sporadike është vënë re që është bërë propagandë nga anëtarë të komisionit të qendrave të votimit, nga vëzhgues të partive politike ose dhe nga përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore.

▪ **Fillimi i procesit të votimit**

Në mjaft qendra votimi të vëzhguara, procesi i votimit ka filluar me vonesë. Vonesat kanë variuar nga gjysmë deri në disa orë, sidomos në disa QV të Elbasanit, Korçës, Tiranës, Durrësit, Shkodrës etj. Këto vonesa erdhën si rezultat i disa faktorëve, si: ngritja me vonesë e KQV-ve (në Tiranë, Elbasan dhe Korçë), trajnimi me vonesë i anëtarëve të komisionit të qendrave të votimit, mbërritja me vonesë e bazës materiale, mungesa e regjistrimit të përkohshëm, mungesa e listave të zgjedhësve etj. Disa komisione të qendrave të votimit kanë filluar votimin pa regjistrin e posaçëm duke mos verifikuar në këtë mënyrë certifikatat e lëshuara nga zyra e gjendjes civile, si p.sh., në Elbasan, Durrës dhe Tiranë.

Në disa KQV të vëzhguara, procesi i votimit ngadalësohej ose ndërpritej për shkak të mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të tyre. Dukej haptas se kjo gjendje reflektonte qëndrime të njëanshme, të politizuara dhe partiake.

▪ **Disa zgjedhës nuk patën mundësi të votojnë**

Në disa qendra votimi kishte persona të cilët nuk mundën të votonin për arsye se emri i tyre nuk figuronte në listat e zgjedhësve, por raste të tilla nuk pasqyroheshin në procesverbalin përkatës, ose nuk kishin dokumentet e verifikimit në përputhje me kërkesat e ligjit.

Votimi i personave të paraburgosur, të dënuar dhe ushtarakët. Me marrëveshjen e nënshkruar mes PD-PS, nga Kodi zgjedhor u hoq çdo dispozitë që kishte të bënte me regjistrin e përkohshëm dhe personat me qëndrim të përkohshëm. Por, pavarësisht nga kjo, edhe pa këtë ndryshim, sipas neneve 76 të pjesës 1, neni 63, pika 2, të Kodit zgjedhor, që nuk kanë ndryshuar, del se në zgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie ose të komunave si dhe të anëtarëve të këshillave bashkiakë ose të komunës marrin pjesë vetëm zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës. Për sa u përket ushtarakëve, në nenin 107 të Kodit zgjedhor që nuk është ndryshuar, thuhet se në zgjedhjet vendore, zgjedhësit që shërbejnë në forcat e armatosura ose në forcat e rendit, votojnë në zonën e qendrës së votimit

¹¹ Kjo është vënë re në disa qendra të vëzhguara, si në Tiranë (1788, 1770, 1714, 1863, 2140, 2110, 1938, 1933, 1814, 3337, 4250, 3657), Gjirokastër (4248, 4250), Durrës (1021, 1018, Qerret), Korçë (3667, 3657), Vlorë (4439, 4465, 4494, 4493, 4377, 4511) dhe Shkodër (259, 260).

të vendbanimit të tyre. Ky është një problem që mund të diskutohet në ndryshimet e mëtejshme që do t'i bëhen Kodit zgjedhor.

Paraqitja e dokumenteve identifikuese

Dokumentet e indentifikimit. Kontrolli i dokumenteve të identifikimit të zgjedhësit bëhej rregullisht me përjashtime të pakta, por ka pasur problem dhe pështjellim me llojin e dokumentacionit që zgjedhësi duhet të paraqiste, siç u tha edhe më lart.

Sipas dispozitave të ndryshuara të Kodit zgjedhor, zgjedhësi kishte detyrimin të paraqiste edhe dy dokumente të tjera shtesë në rast se kishte certifikatë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile para datës 1 nëntor 2006. Në rast se certifikata ishte e lëshuar pas datës 1 nëntor 2006, atëherë komisioni i qendrës së votimit duhet të verifikonte numrin e certifikatës së personit në regjistrin e posaçëm. Komisioni duhet të mbante një fotokopje të certifikatës ose origjinalin. Kjo dispozitë jo në të gjitha rastet është zbatuar. Ka pasur raste që, me konsensusin e komisionerëve, në disa qendra votimi, sidomos në Durrës, është votuar me pasaportë të skaduar. Pati disa raste kur edhe pse certifikata nuk gjendej e regjistruar në regjistrin e posaçëm të certifikatave, është pranuar nga komisioni. Probleme u vunë re edhe në lidhje me pengesat që u nxirreshin votuesve kur ata ishin të pajisur me certifikata të ditëve të fundit, pasi nuk ishin regjistruar në regjistrin e posaçëm.

Ndalimi i votimit dy herë

Siguria në zgjedhje dhe përdorimi i bojës së ngjyrosur. Sipas nenit 100, germa “dh”, boja që timbros zgjedhësin, nuk duhet të hiqet para 24 orëve. Vëzhguesit në Fier, Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës informuan që në orët e para të votimit se boja fshihej lehtësisht me alkool, aceton dhe me ujë të ngrohtë. Jo në të gjitha rastet zgjedhësit kontrolloheshin nga të dyja duart nëse ishin timbrosur më përpara ose jo. Gjithashtu, në disa raste, zgjedhësve nuk u është vendosur boja në gisht ose janë timbrosur në dorën e djathtë.

Sipas legjislacionit zgjedhor, zgjedhësi duhet të firmosë përbri emrit të tij. Ardhja me vonesë e listave të zgjedhësve ka bërë që votuesit e parë të votojnë duke u mbajtur shënim emrat në një letër të bardhë.

Personat të cilët nuk mund të votojnë vetë

Sipas neni 103 të Kodi zgjedhor, në rastin kur një person nuk është në gjendje të votojë vetë, atëherë kryetari i komisionit të qendrës së votimit duhet të caktojë një person për ta ndihmuar të ushtrojë të drejtën e tij politike. Një person nuk lejohet të ndihmojë më shumë se një person. Personi që nuk mund të votojë vetë, duhet të bëjë një deklaratë nëpërmjet së cilës të shprehet se kërkon ndihmë.

Në përgjithësi, në shumicën e qendrave të vëzhguara ka pasur keqinterpretim ose mosrespektim të ligjit. U vunë re raste kur një person ndihmonte më shumë se një person që nuk mund të votonte vetë si dhe raste të votimit familjar. Ka pasur edhe raste kur ndihma

është dhënë nga anëtarë të komisionit të qendrave të votimit dhe vëzhgues vendorë ose vëzhgues të subjekteve politike. Për shkeljet e konstatuara, vëzhguesit e KShH-së kanë bërë vërejtje me shkrim.

Votimi nga personat me aftësi të kufizuar fizike

Votimi i personave me aftësi të kufizuar ose në pamundësi për të votuar pati probleme në disa qendra votimi, në të cilat zgjedhës të moshave të vjetra janë lejuar të votojnë bashkë dhe, në disa raste, janë ndihmuar dhe janë orientuar nga anëtarë të komisionit të qendrës së votimit. Vëzhguesit konstatuan se kishte persona që, për arsye fizike, kanë pasur vështirësi hyrjeje në mjediset e qendrës së votimit, sidomos në Tiranë.

Mjediset e qendrave të votimit

Procesi i votimit në përgjithësi u zhvillua qetësisht, pa presione nga kandidatët ose mbështetësit e tyre. Në disa qendra votimi, për shkak të numrit të madh të komisionerëve, vëzhguesve të subjekteve politike, mjediseve të vogla dhe zgjedhësve që prisnin të votonin, krijohej një situatë kaosi. Kjo edhe për arsye të fillimit me vonesë të procesit të votimit. Radhët e gjata të zgjedhësve u vunë re sidomos orët e fundit të procesit të votimit.

Në disa qendra votimi kanë hyrë edhe persona të pautorizuar, të cilët pretendonin të ishin vëzhgues, por pa akreditim, si në Korçë etj.

Mbyllja e votimit

Procedurat për mbylljen e qendrave të votimit, pavarësisht se në disa prej tyre votimi vazhdoi pas orës 18:00, përfundoi pa probleme, me përjashtim të një qendre votimi në njësinë bashkiake të Kombinatit në Tiranë. Nuk u konstatuan parregullsi apo incidente edhe gjatë transportimit të tyre në qendrat e numërimit të votave.

Pothuajse në të gjitha vendet e numërimit, kutitë e votimit kanë mbërritur me vonesë, për shkak të përfundimit me vonesë të procesit të votimit. Vëzhguesit e KShH-së konstatuan se marrja në dorëzim e kutive të votimit dhe e kutive të materialeve të votimit në përgjithësi u bë në përputhje me ligjin. Në ndonjë rast, në kutitë e votimit, KQV-ja i kishte vendosur mbrapsht kodet e sigurisë.

9. PROCEDURAT PËR NUMËRIMIN E VOTAVE

Koha e fillimit të numërimit të votave ka qenë e ndryshme, por, në përgjithësi, me vonesë, madje në disa qendra në orët e para të mëngjesit të datës 19 shkurt 2007, si p.sh., në Tiranë, Gjirokastër, Elbasan, Durrës etj. Ka pasur edhe raste kur procesi është ndërprerë për shkak të diskutimeve për raste konkrete ose konflikte midis anëtarëve të këtyre grupeve.

Mes anëtarëve të komisioneve të numërimit lindën kundërshti për çështje teknike ose mosnjohjeje të ligjit. Ndikimi partiak ka qenë i theksuar.

Pati ndërprerje apo bllokime sidomos kur procesi i numërimit ishte në mbarim, kur mbeteshin pa numëruar një ose më shumë kuti votimi dhe kur ishte evident kandidati fitues. Kjo dukuri kishte të bënte, gjithashtu, me ndikime apo qëndrime të politizuara partiake.

Në vendet e numërimit të votave ka pasur shumë pështjellim për shkak të numrit të madh të personave të pranishëm, që në të shumtën e rasteve e përbënin vëzhguesit e partive politike, madje kishte edhe ata që nuk kishin autorizimin përkatës.

Në disa raste, KZQV-të, për të pasur situatën nën kontroll në momentet e acarimit dhe të degradimit të procesit, kanë thirrur forcat e rendit, si p.sh., në Tiranë, Fier, Gjirokastrë, Vlorë, Durrës etj.

Numërimi i votave në të gjitha KZQV-të përfundoi jashtë afatit ligjor dhe me shumë vonesë. Për këtë qëllim, KShH-ja ka reaguar nëpërmjet një deklarate për shtyp për zhblokimin e procesit të numërimit dhe përshpejtimin e nxjerrjes së rezultateve¹².

Tabela e rezultateve jo në të gjitha rastet nënshkruhej nga të gjithë anëtarët e grupeve të numërimit.

¹² Shih deklaratën e KShH-së në shtojcën nr. 1: “T” i jepet fund sa më parë procesit të numërimit të votave”, datë 19 shkurt 2007.

10. PËRFUNDIME DHE SUGJERIME

Mbështetur në të dhënat dhe në raportet e vëzhguesve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, duke i analizuar ato me sy kritik dhe objektivitet dhe duke pasur parasysh se vëzhgimi u shtri vetëm në një pjesë të njësive zgjedhore, kryesisht në disa momente të procesit zgjedhor, arrihet në këto përfundime:

1. Ndryshimet në Kodin zgjedhor u bënë 36 ditë para ditës së zgjedhjeve. Pasojat negative të kësaj vonese të theksuar reflektuan në mënyrë negative në të gjitha aspektet e procesit zgjedhor, si në:
 - veprimtarinë e KQZ-së;
 - ngritjen me vonesë të KZQV-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit të votave dhe, si rrjedhim, në trajnimin formal ose mostrajnimin e tyre.
2. Zgjedhësit ushtruan të drejtën e tyre të votës. Nuk u vërtetuan presione mbi zgjedhësit për të votuar ose për të mos votuar për kandidatë apo për parti të caktuara.
3. Edhe pse kontestimet për listat e zgjedhësve në krahasim me të kaluarën ishin relativisht të pakta për shkak të kohës së kufizuar të njohjes së tyre nga zgjedhësit, ushtrimi i së drejtës së ankimit për mangësi apo pasaktësi në këto lista nuk u arrit të realizohej në të gjitha rastet.
4. Në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Kodit zgjedhor, u lejuan, madje, në raste të veçanta, u inkurajuan mosrespektimi i fshehtësisë së votës, si dhe votimi në grup ose “familjar”. U vërtetuan raste të ndihmës që i njëjti person u jepte disa zgjedhësve që nuk kishin mundësi të votonin vetë, si dhe raste të tjera në të cilat nuk bëhej identifikimi i zgjedhësit.
5. Edhe pse fillimisht fushata zgjedhore ishte relativisht e qetë dhe e ekuilibruar, edhe pse mjaft kandidatë dhe parti politike shpalosën alternativat e tyre me afrimin e datës së zgjedhjeve, atmosfera politike u tensionua, Kodi i etikës nuk u zbatua, ndërsa propaganda zgjedhore në disa raste u shoqërua me gjuhën e urrejtjes, gjë që ndikoi edhe në veprimtarinë e komisioneve zgjedhore.
6. Shqyrtimi i çështjeve të ndryshme në KQZ u mbështet kryesisht në zbatimin e Kodit zgjedhor. Megjithatë, ai nuk u shpëtoi elementeve të natyrës politike dhe të kundërvënieve të personalizuara.
7. Në KZQV-të, në KQV-të dhe sidomos në grupet e numërimit të votave, në mjaft raste binte në sy njëanshmëria, mbrojtja e interesave të ngushtë partiakë, politizimi në dëm

të zbatimit rigoroz të ligjit, konfliktualiteti midis anëtarëve të propozuar nga partitë e pozitës dhe të opozitës. Atmosfera konfliktuale në disa raste çoi në ndërprerjen ose bllokimin e procesit të numërimit të votave. Ndikim negative pati edhe prania e përfaqësuesve të partive politike, të kandidatëve dhe të personave të tjerë, sidomos ditën e numërimit të votave.

8. Edhe pse nga data 18 shkurt 2007 kanë kaluar 40 ditë, vazhdon shqyrtimi i ankesave nga KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit, Tiranë. Siç duket, për arsye të ndryshme që kërkojnë analizë të veçantë, rezultatit përfundimtar i zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007 do të shpallet me vonesë. Kemi parasysh edhe faktin se në 8 ose 9 njësi zgjedhore ku zgjedhjet nuk u zhvilluan, ato do të kryhen në një datë tjetër.
9. Pa pretenduar se konkluzionet e një organizate monitoruese në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007, siç është edhe KShH-ja, të jenë të plota dhe të padiskutueshme, me keqardhje mund të thuhet se standardet e kërkuara nuk u arritën. Në këtë vështrim mendojmë se është e nevojshme të bëhen analiza të thelluara, gjë që do t'i shërbente hartimit dhe miratimit të një reforme më të plotë zgjedhore. Jemi të ndërgjegjshëm se, pasi të njihemi me raportin e OSBE/ODIHR-it dhe me rekomandimet përkatëse që do të paraqiten në këtë raport, do të kemi një tablo më të qartë, si për përgatitjen, për ecurinë e zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007, ashtu edhe për vlerësimin që do të bëhet në aspektin e arritjes të standardeve ndërkombëtare.

Sugjerime

1. Është e nevojshme të fillohet menjëherë nga puna për përmirësimin dhe plotësimin e reformës zgjedhore në të gjitha aspektet e saj: zgjedhjet parlamentare, referendumet dhe zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore. Për të mos u vonuar do të ishte mirë të veprohej me urgjencë, pa pritur rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007 dhe raportin e OSBE/ODIHR-it për këto zgjedhje
2. Paraprakisht, mendojmë se partitë politike mund të diskutonin dhe të vendosnin për këto çështje:
 - Sistemin e zgjedhjeve. Në varësi të zgjidhjes së kësaj çështjeje mund të shqyrtohej problemi nëse duhet të vazhdohej me këtë numër deputetësh dhe me pragun ekzistues elektoral apo ato duhet të pësonin ndryshime.
 - Nëse neni 22 i Kodit zgjedhor ku përcaktohet procedura e zgjedhjes së anëtarëve të KQZ-së do të vazhdonte sipas formulimit në fuqi apo ai duhet të riformulohej në përputhje me nenin 154 të Kushtetutës. Ky është një nga rekomandimet e parashtruara më së një herë nga OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias.

KShH-ja, duke pasur parasysh përvojën e zgjedhjeve të viteve 2003, 2005 dhe të 18 shkurtit 2007, sugjeron që neni 22 i Kodit zgjedhor të riformulohet.

- Nëse KZZ-të, KZQV-të, KQV-të dhe grupet e numërimit të votave do të vazhdojnë siç janë sot, me këtë numër dhe me këtë përbërje, apo procedura e ngritjes së tyre është e nevojshme të ndryshojë.

KShH-ja, duke pasur parasysh përvojën e zgjedhjeve 1996 – 2007, faktin se komisionet zgjedhore kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë burim i së keqes, fakt ky i evidentuar edhe në të gjitha raportet e OSBE/ODIHR-it, mendojmë se, në kushtet aktuale të vendit tone, ato nuk duhet të krijohen në bazë të propozimeve partiake, siç përcaktohet në Kodin në fuqi, por të përbëhen nga teknicienë dhe profesionistë që japin më tepër garanci për pavarësi dhe zbatim të ligjit jashtë ndikimeve partiake.

- Në rast të ndryshimit të sistemit elektoral, mund të shqyrohej, gjithashtu, edhe ndarja më e përshtatshme administrative, gjë që do të kërkonte konsultime edhe me organet e qeverisjes vendore.

3. Brenda këtij viti ose brenda 6-mujorit të parë të vitit 2008 do të sugjerohet të krijohej regjistri i saktë i zgjedhësve, i mbështetur në adresat përkatëse. Po brenda kësaj periudhe të përgatitshin edhe kartat e identitetit.
4. Pasi Kuvendi të ketë zgjidhur dhe të ketë miratuar çështjet e sugjeruara në pikat 2 dhe 3 të përmendura më lart, në interes të shpejtimit të procesit zgjedhor dhe të cilësisë të formulimeve tekniko-ligjore dhe kushtetuese, do të sugjerohet që hartimi i projektndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin zgjedhor t'i besohet një grupi specialistësh vendës me përvojë në këtë fushë. Asistenca e specialistëve të huaj do të ishte gjithashtu e nevojshme dhe e mirëpritur.
5. Në hartimin e projektndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin zgjedhor sugjerohet të kihen parasysh rekomandimet e OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias, paraqitur në raportet e viteve 2001, 2004, 2005 dhe në raportin e pritshëm për zgjedhjet e 18 shkurtit, si dhe raportet e vëzhguesve vendorë, problemet e tjera që ka diktuar praktika dhe kushtet konkrete të vendit tonë.
6. Për të parandaluar vonesat në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve do të sugjerohet të rishikoheshin të gjitha dispozitat e Kodit në fuqi që kanë të bëjnë me procedurat e ankimeve dhe të apelineve.
7. Kodi zgjedhor duhet të garantonte të drejtën efektive dhe të besueshme të votimit si në zgjedhjet parlamentare, ashtu edhe në ato të qeverisjes vendore për një kategori të caktuar zgjedhësish, siç janë: të paraburgosurit, të dënuarit, të sëmuret që mjekohen

në institucionet shëndetësore, ushtarakët që ditën e zgjedhjeve ndodhen jashtë vendbanimit të tyre, të paaftët apo të moshuarit që nuk mund të lëvizin.

8. Sugjerojmë, gjithashtu, të diskutohet edhe çështja e votimit të emigrantëve me shtetësi shqiptare në vendet ku ato ndodhen.

KShH-ja mendon se zgjidhja e këtij problemi ka disa vështirësi, sepse kjo duhet të garantonte jo vetëm ushtrimin e së drejtës së votës, por edhe sigurimin e saj duke përjashtuar çdolloj manipulimi.

9. Duke pasur parasysh se zgjedhjet e zakonshme parlamentare do të zhvillohen në vitin 2009, sugjerojmë që projekti i ndryshimeve dhe plotësimeve të Kodit zgjedhor të miratohet një vit para datës së votimeve. Kjo do të krijonte mundësinë e administrimit më të mirë të zgjedhjeve në të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Veç kësaj nuk do të ishte e rekomandueshme që ndryshimi i sistemit dhe i ndarjes së re administrative (nëse do të arrihej konsensusi i gjerë për ndryshimin e tyre) të bëhej 6 muaj apo 9 muaj para datës së zgjedhjeve.

ANEKS 1 DEKLARATAT E KSHH-SË

1. Njoftim për shtyp

Tiranë, më 13 Janar 2007

KSHH përshëndet nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet pozitës dhe opozitës duke kapërcyer krizën zgjedhore me pasoja të rënda. Kjo marrëveshje edhe pse tepër e vonuar, vërtetoi se vetëm nëpërmjet dialogut konstruktiv mund të zgjidhen edhe çështje të vështira që kanë të bëjnë me interesa madhore. KSHH përshëndet me këtë rast këmbënguljen, durimin dhe përgjegjshmërinë e lartë të Presidentit të Republikës për kontributin e tij të veçantë në arritjen e kësaj marrëveshjeje. Ne përshëndesim dhe vlerësojmë gjithashtu edhe interesimin dhe asistencën direkte të faktorit ndërkombëtarë.

KShH-ja konsideron të domosdoshme miratimin me urgjencë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor për të mundësuar menjëherë zbatimin e ligjit brenda afateve mjaft të reduktuara zgjedhore.

Duke patur parasysh kohën e shurtër që na ndan nga data e zgjedhjeve, KSHH mendon se parësore janë: shpallja e listave të zgjedhësve, regjistrimi në KQZ i subjekteve zgjedhore, ngritja e KZQV-ve dhe regjistrimi në KZQV-të i kandidatëve.

KShH-ja u bën thirrje zgjedhësve që të tregojë interes për t'u njohur me listat që do të shpallen, të kërkojnë kur është rasti, korrigjimin e tyre dhe të ushtrojnë të drejtën kushtetuese për të marrë pjesë gjerësisht në votime, gjë që do t'i shërbente demokratizimit të mëtejshëm të organeve të qeverisjes vendore, si rrjedhim i interesave të popullit dhe integritit të vendit tonë në strukturat euro-atlantike.

Synimin për zgjedhje të lira dhe të ndershme mund ta kompromentonte vazhdimi i atmosferës së acaruar politike gjë që do të vinte në pikëpyetje arritjen e standardeve që kërkohen.

Është pikërisht kjo, arsyeja që KShH-ja e shikon të nevojshme t'u bëjë gjithashtu thirrje partive politike dhe sidomos dy partive më të mëdha të zhvillojnë një fushatë zgjedhore të kulturuar dhe pa eksese.

2. Thirrje; Të gjitha partive politike në Shqipëri dhe kandidatëve të tyre për kryetar bashkie ose komune

Tiranë, më 18 Janar 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Studimet Parlamentare, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur (SOROS), Shoqata për Kulturë Demokratike, Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Koalicioni për Nxitjen e Pjesëmarrjes së Grave, të Rinjve dhe Minoriteteve në Politikë, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Forumi i mendimit të lirë, Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve,

Ne, organizatat nënshkruese të kësaj thirrje, përshëndesim zgjidhjen e krizës politike në të cilën ishte përfshirë vendi, zbutjen e atmosferës politike që rrezikonte zgjedhjet vendore në vendin tonë si dhe imazhin e Shqipërisë në botë.

Zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore do të zhvillohen në 18 shkurt 2007. Fushata zgjedhore edhe pse ende e pazyrta, realisht ka filluar.

Organizatat tona i bëjnë thirrje partive politike dhe kandidatëve të tyre që të zhvillojnë një fushatë zgjedhore të ligjshme, të respektueshme dhe të kulturuar.

Kandidatët e forcave të ndryshme politike nuk duhet t'u flasin zgjedhësve me gjuhën e urrejtjes, me akuza të ndërsjellta deri edhe me akuza të përfshirjes në veprimtari kriminale. Në takimet dhe veprimtaritë e tjera të tyre, kandidatët duhet të trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me alternativat më të mira për të çuar më përpara arritjet e deritanishme dhe zgjidhjen e problemeve shqetësuese për qytetarët dhe vendin.

Nga përvoja e viteve të kaluara, shpesh kandidatët kanë marrë përsipër gjëra që nuk mund t'i kryenin, ose kanë premtuar për gjëra realisht të parealizueshme.

Ne kërkojmë nga ju, më tepër transparencë dhe një konkurim me dinjitet, nëpërmjet paraqitjes së alternativave dhe një vizioni largpamës për zhvillimin e qyteteve dhe komunave ç'ka ndihmon në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në Shqipëri. Në këtë drejtim, etika e komunikimit midis vetë kandidatëve si dhe kandidatëve dhe qytetarëve është element i rëndësishëm i demokracisë.

Ne kërkojmë nga ju që gjatë fushatës elektorale të respektoni të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe ato të fëmijëve në veçanti. Partitë politike dhe kandidatët e tyre duhet të marrin masa që të shmangin përdorimin e fëmijëve si sfond për fushatën elektorale.

Zgjedhjet e lira dhe të ndershme janë një test i rëndësishëm për të ardhmen e Shqipërisë dhe integrimin e vendit tonë në Bashkimin Europian dhe NATO. Për të realizuar një qëllim kaq madhor ne besojmë se partitë politike në Shqipëri dhe kandidatët e tyre mund të japin një kontribut me vlerë.

3. Vonesat janë shqetësuese

Tiranë më 19 janar 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit bashkohet me shqetësimin e KQZ-së se si pasojë e mosparaqitjes nga partitë politike përkatëse të propozimeve për anëtarë të KZQV-ve, këto komisione do të ngrihen me vonesë duke shkelur kështu pikën 2 të nenit 181/1 të ndryshuar të Kodit Zgjedhor ku thuhet se: "KQZ-ja miraton përbërjen e KZQV-ve brenda 7 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji".

Vonesa në ngritjen e KZQV-ve do të shkelte edhe pikën 3 të nenit të mësipërm që kërkon paraqitjen në KZQV të dokumentacionit të kandidatëve për kryetar bashkie ose komune apo për këshillin e bashkisë ose komunës, jo më vonë se data 23 Janar 2007 dhe miratimi i këtij dokumentacioni jo më vonë se 25 Janari 2007.

KSHH vëren gjithashtu se edhe pse fushata zgjedhore në fakt ka filluar, zyrtarisht ajo fillon pas miratimit të dokumentacionit të kandidatëve nga KZQV-ja.

KSHH shpreh gjithashtu shqetësimin se nxitimi nga ana e KQZ-së në ngritjen e KZQV-ve si pasojë e vonesave të propozimeve nga partitë politike, mund të ndikojë negativisht në verifikimin e kriterëve dhe kushteve ligjore që kërkon ligji për të qenë anëtar i KZQV-së.

KSHH mendon gjithashtu se trajnimi i 3692 anëtarëve të KQZ-së dhe 284 sekretarëve të KQZ-së do të jetë i vështirë. KSHH është e mendimit se do të ishte gabim që ata të fillonin nga puna pa qenë trajnuar më parë.

KSHH vëren gjithashtu se sipas pikës 3 të nenit 40 (Dispozita kalimtare) të Kodit Zgjedhor, listat paraprake të zgjedhësve duhet të shpallen jo më vonë se data 21 Janar 2007. Nëse KZQV-të ngrihen me vonesë, asnjë organ tjetër nuk mund të shqyrtojë kërkesat e zgjedhësve kur në këto lista mund të mos gjejnë emrin e tyre. Kjo do të dëmtonë rëndë të drejtën e zgjedhësve për t'u ankuar brenda afateve të caktuara Ligjore.

Për Komitetin Shqiptar të Helsinkit, veprimtarinë normale të KQZ-së e pengon mospërmbushja nga ana e partive politike e detyrimeve Ligjore. Është kjo arsyeja që KSHH-ja u bën thirrje partive politike që të zbatojnë detyrimet e tyre Ligjore. Vonesat çënojnë ecurinë normale të aspekteve të ndryshme të procesit ligjor dhe si rrjedhim edhe standardet që kërkohen.

4. Fushatë e kulturuar. Jo gjuhës së urrejtjes. Jo cënimit të dinjitetit të njeriut dhe të drejtës së privatësisë

Tiranë, më 22 Janar 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe disa organizata të tjera jo-qeveritare, të angazhuara në fushën e respektimit të lirive dhe të drejtave të shtetasve, si në zgjedhjet e mëparshme, edhe para zgjedhjeve të afërme të organeve të qeverisjes vendore, u kanë bërë thirrje partive politike që të zhvillojnë një fushatë zgjedhore të kulturuar, të ligjshme dhe pa eksese.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, para disa ditësh, u propozoi partive politike që të nënshkruanin një Kod Sjelljeje për fushatën zgjedhore. Në këtë Kod midis të tjerave theksohet se: “partitë politike duhet të respektojnë Kodin Zgjedhor...”, se “Partitë politike dhe kandidatët nuk do të botojnë apo të bëjnë akuza shpifëse apo irrituese rreth partive, kandidatëve apo personave të tjerë...”.

Në mbështetje të këtij propozimi u prononcuan menjëherë përfaqësuesit e PD-së, PS-së, PDK-së, LSI-së, PDR-së dhe të partive të tjera.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit me keqardhje konstaton se lideri i PD-së në hapjen zyrtare të fushatës elektorale të 20 Janarit 2007, në adresë të liderit të PS-së dhe kandidatit të bashkisë së Tiranës, kaloi dukshëm kufijtë e kritikave ndaj kundërshtarit politik duke përdorur fjalë fyese të shoqëruara me epitete që prekin dinjitetin e personit dhe çënojnë të drejtën e privatësisë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit konsideron të papranueshëm përdorimin e një fjalori të tillë midis kundërshtarëve politikë, të papajtuësishëm me çdo etikë njerëzore si dhe me Kodin e Sjelljes që duhet të zbatohet në fushatat elektorale.

Subjektet zgjedhore, sipas nenit 133 të Kodit Zgjedhor, janë të detyruar që propagandën e tyre zgjedhore ta zhvillojnë me çdo mënyrë të ligjshme.

E shikojmë të nevojshme të përmendim gjithashtu se neni 35 i Kushtetutës sonë dhe neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kërkojnë respektimin e jetës private dhe familjare.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit me këtë rast u bën thirrje edhe një herë partive politike të shmangin damkosjen e këtij ose atij personi me akuza të karakterit kriminal që mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm nga organet kompetente. *Respektimi i parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë është i detyrueshëm për të gjithë.*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka mendimin se jo gjuha e urrejtjes, por konkurimi elektoral nëpërmjet shpalesjes së alternativave më të mira dhe më bindëse qeverisjeje është tregues i rëndësishëm që ndikon pozitivisht në arritjen e standardeve zgjedhore.

5. Njoftim për shtyp

Tiranë, më 24 janar 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja) organizata e parë joqeveritare (jofitimprurëse), ka monitoruar dhe do të vazhdojë të monitorojë zgjedhjet periodike në Shqipëri. Qëllimi i vëzhgimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të 18 shkurtit 2007 është të kontribuojë për respektimin e votës së lire të zgjedhësve, zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike dhe për përmirësimin e mëtejshëm të reformës zgjedhore në frymën e dokumentave ndërkombëtare¹³.

KShH-ja do të angazhojë rrjetin e vëzhguesve dhe të korrespondentëve të tij në rrethet ku ata veprojnë, vullnetarë dhe aktivistë të të drejtave të njeriut. KShH-ja është në procesin e akreditimit të rreth 150 vëzhguesve afatgjatë dhe afatshkurtër. Vëzhgimi do të shtrihet kryesisht në rrethet: Tiranë, Durrës, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë dhe Elbasan. Më qëllim që të rritet niveli profesional i vëzhguesve, për njohjen më mirë të ndryshimeve të bëra në Kodin zgjedhor, për të zbatuar metodologjinë e vëzhgimit sa më të efektshme, *më 27 janar 2007 do të zhvillohet trajnimi i vëzhguesve të KSHH-së.*

Për një informim më të mirë të publikut për të drejtën e votës, verifikimin e emrit në listë, procedurat e votimit dhe sensibilimin e votuesve për të marrë pjesë në zgjedhje, KShH-ja do të përgatisë *një fletëpalosje si dhe 3 suplementa të cilat do të botohen në gazetat e përditshme.*

Fushat e monitorimit të KSHH-së për zgjedhjet vendore 2007 do të jenë: aspekte të veçanta të fushatës zgjedhore, shpallja e listave të zgjedhësve dhe ushtrimi i së drejtës së ankimimit nga votuesi, respektimi i Kodit të Etikës nga partitë politike dhe kandidatët e tyre; procesi i votimit dhe numërimit të votave. Gjithashtu, KSHH-ja do të ndjekë mbarëvajtjen e përgatitjes për zgjedhje dhe në varësi të problemeve që mund të dalin, KShH-ja do të mbajë kontakte me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe organizatat e tjera vëzhguese përgjegjëse. Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe problemet që mund të shfaqen, KShH-ja mund të dalë me reagime publike, të informojë institucionet përkatëse për zgjidhjen e problemeve. Në përfundim të procesit të votimit do të dilet me një raport paraprak dhe në përfundim të procesit zgjedhor me një raport përfundimtar ku do të përshihen edhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e procesit zgjedhor në Shqipëri.

KShH shpreh besimin se edhe organizatat e tjera vëzhguese vendore do të tregojnë objektivitet dhe profesionalizëm në vëzhgimin e aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor.

¹³ Monitorimi i procesit parazgjedhor dhe atij zgjedhor do të mundësohen financiarisht nga CORDAID

6. Partitë dhe kandidatët e tyre të zbatojnë kodin zgjedhor dhe kodin e Sjelljes

Tiranë, më 30 Janar 2007



Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Shoqata për Kulturë Demokratike, Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit, Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut, Lëvizja MJAFT, Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve, KRIIK Albania, Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut, Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve

Organizatat vëzhguese për monitorimin e Kodit të Sjelljes për organet e qeverisjes vendore të 18 shkurtit 2007, të iniciuar nga Presidenti i Republikës dhe të pranuar nga forcat politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje, kanë vëzhguar respektimin e disa aspekteve të Kodit të Sjelljes dhe të Kodit Zgjedhor që nga fillimi i fushatës zgjedhore.

Ato konstatojnë se që në fillim të fushatës binte në sy gjuha e ashpër dhe cënimi i jetës private të kandidatëve. Pas kësaj në përgjithësi vihet re një rënie e gjuhës së urrejtjes.

Ka përpjekje pozitive nga media për të pasqyruar jo vetëm fushatat dhe programet e kandidatëve dhe partive, por edhe për informimin e publikut.

Organizatat nënshkruese të kësaj deklarate përshëndesin iniciativën e përbashkët të zëdhënësve të disa partive politike për fushatën elektorale dhe mbeshtesin çdo iniciativë që do t'i shërbente zhvillimit të një fushate të ligjshme dhe kulturuar.

Megjithë zhvillimet pozitive në vërejmë se:

- Nuk ka transparencë të financimeve dhe sponsorizimeve të marra nga kandidatët. Madje partitë politike nuk kanë bërë ende publike edhe shpenzimet financiare të zgjedhjeve të 3 korrikut 2005.
- Vihet re përdorimi i fondeve publike të institucioneve shtetërore. Në disa rrethe, administrata shtetërore dhe vendore detyrohet të angazhohet në fushatë.
- Drejtues të administratës publike, në kundërshtim me statusin e tyre dhe ligjin, marrin pjesë në fushatat e kandidatëve të ndryshëm.
- Kandidatë për kryetar bashkie në rrethet Korçë, Lezhë, Shkodër, etj, presin shiritat e inaugurimit të investimeve të qeverisë, të ndërtuara me paratë e buxhetit të shtetit dhe taksat e qytetarëve.
- Në disa qytete si: Fier, Durrës, Vlorë janë shënuar incidente të panevojshme mes simpatizantëve të partive për përbërjen e komisioneve.

- Në qytetet Gjirokastrë, Tiranë, Elbasan, Lushnjë janë vënë re mosmarrëveshje për vendosjen e posterave të kandidatëve.
- Ka kandidatë që mbajnë poste të larta zyrtare, të cilët nuk kanë dhënë dorëheqje, si një akt moral i mirëpritur. Ata përdorin autoritetin, postin dhe mjetet e shtetit për fushatën elektorale.
- Në spotet televizive vihet re një keqpërdorim i institucioneve shtetërore për qëllime elektorale të kandidatëve të veçantë.
- Në listat e këshilltarëve janë përfshirë persona nën hetim dhe të shkarkuar për shkelje të ligjit. Veprime të tilla janë të papranueshme moralisht, ndonëse ne respektojmë parimin e prezumimit të pafajësisë.
- Disa kandidatë në fushatat e tyre akuzojnë kundërshtarin politik duke shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë.
- Partitë politike nuk po bëjnë aq sa duhet për sensibilizimin e qytetarëve lidhur me listat, vendin e shpalljes së tyre, numrin e votuesit, përdorimin e çertifikatave dhe vendodhjen e qendrave të votimit.

Bazuar në kërkesat e Kodit Zgjedhor, të Kodit të Sjelljes dhe në kërkesën për realizimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe demokratike, organizatat tona vëzhguese i bëjnë thirrje partive politike dhe kandidatëve të tyre:

- Partitë politike të respektojnë Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Sjelljes duke u bërë thirrje publike kandidatëve e strukturave të distancohen nga veprimet abuzive.
- Qeveria dhe opozita të nxisin kandidatët për një ndarje të qartë të tyre nga konfliktet e interesit.
- Media të thellojë paanshmërinë dhe të mbajë qëndrim ndaj veprimeve negative që shfaqen në fushatat e kandidatëve.
- Institucionet shtetërore të mos lejojnë keqpërdorimin e tyre në fushatë.
- Partitë politike dhe kandidatët e tyre të mos bëjnë premtime jo reale dhe të perealizueshme por të përqëndrohen në projekte konkrete për zhvillimin e njësisë vendore ku ata kandidojnë.
- Partitë politike të respektojnë vendet e përcaktuara nga organet e qeverisjes vendore për vendosjen e posterave të subjekteve zgjedhore.
- Partitë politike të përshihen në informimin e simpatizantëve të tyre për nevojën e rishikimit të listave, të vendit të shpalljes së tyre, të ushtrimit të së drejtës së rishikimit dhe korigjimit të tyre.
- Partitë politike të angazhohen, në kohë dhe seriozisht, për hartimin e listës së anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit dhe të anëtarëve të grupeve të numërit të votave.
- Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të marrë masa për trajnimin e anëtarëve të qendrave të votimit dhe të komisioneve të numërimit të votave.

7. Thirrje zgjedhëse! Listat paraprake dhe përfundimtare të zgjedhëse mund të ndryshojnë
Tiranë më 2 shkurt 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit u bën thirrje të gjithë zgjedhësve që për ushtrimin e të drejtës kushtetuese të votës në Zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore që do të zhvillohen në 18 shkurt 2007, të njihen si me listat paraprake që do të vazhdojnë të jenë të shpallura deri në datën 6 shkurt 2007, dhe me ato përfundimtare të zgjedhësve që do të shpallen në datën 7 shkurt 2007.

Është e drejtë e çdo zgjedhësi që kur emrin e tij nuk e gjen në listat paraprake t'i drejtohet me shkrim kryetarit të njësisë të qeverisjes vendore ku ai ka banimin dhe po të jetë nevoja edhe gjykatës në rast se kërkesa e tij nuk merret parasysh.

Nga të dhënat e mbledhura nga vëzhguesit e KShH-së në Tiranë dhe disa rrethe të tjera rezulton se sensibilizimi dhe propaganda zgjedhore për ndërgjegjësimin e zgjedhësve, për hartimin dhe verifikimin e emrave në listë dhe korrigjimin e tyre në raste të nevojshme është relativisht i dobët.

Meqënëse koha për rishikimin e listave është tepër e shkurtër, KShH-ja i bën thirrje gjithë votuesve që të njihen me vendin e shpalljes së listave, me emrat e tyre dhe të familjarëve në lista.

Duke patur parasysh përvojën e zgjedhjeve të mëparshme, KShH u bën gjithashtu thirrje zgjedhësve që të tregojnë interes për t'u njohur edhe me listën përfundimtare të zgjedhësve sepse edhe në këto lista mund të ketë mungesa e pasaktësi. Sipas ligjit në këtë rast zgjedhësi ka të drejtë ti drejtohet gjykatës.

KShH mendon se me një punë intensive dhe të përditshme duke përdorur të gjitha mjetet dhe format sensibilizuese, do të arrihet në përgatitjen e listave ku do të përfshihen të gjithë shtetasit që kanë të drejtën e votës.

8. Ngritja me vonesë e komisioneve të qendrave të votimit – mund të cënojë të drejtën e shtetasve për të votuar

Tiranë më 5 shkurt 2007

Sipas nenit 45 të Kodit zgjedhor, Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV-të) duhet të emërohen nga KZQV-të, jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve, d.m.th jo më vonë se data 8 shkurt 2007.

Mbetet ende edhe 3 ditë nga përfundimi i afatit të zbatimit të kësaj kërkesë ligjore. KZQV-të janë në pritje të propozimeve përkatëse të partive politike. Nga ana tjetër, anëtarët e KQV-ve duhet të përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Këtë duhet ta kenë parasysh jo vetëm partitë propozuese por edhe KZQV-të që do ti miratojnë ato.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dëshiron të bëjë me dije se janë mbi 65 mijë anëtarë dhe sekretarë të KQV-ve që duhet të emërohen. Studimi i propozimeve të partive lidhur me anëtarët e KQV-ve dhe verifikimet e tyre kërkojnë kohë. Koha kur duhet zbatuar kjo detyrë ligjore është tepër e ngushtë. KShH ka parasysh faktin se krijimi me vonesë i KQV-ve do të vështirësojë së tepërmi trajnimin e tyre.

KShH ka parasysh gjithashtu se, me ndryshimet ju bënë kodit zgjedhor, sidomos lidhur me përdorimin e çertifikatave të lindjes të lëshuara nga zyrat e gjëndjes civile para dhe mbas krijimit të

rregjistrin të posaçëm (1 Nëntor 2006), trajtimi në kohë dhe me cilësi të anëtarëve të KQV-ve është i domosdoshëm.

Është kjo arsyeja, që KShH u bën thirrje partive politike që të jenë korrekte me zbatimin e ligjit dhe menjëherë të paraqiten në KZQV-të përkatëse propozimet e tyre.

Mosrepektimi i kërkesave të ligjit lidhur me cilësitë dhe trajnimin e anëtarve të komisioneve të qëndrave të votimit dhe vonesat në këtë proces mund të shkelen procedurat që duhen zbatuar ditën e votimit dhe si pasojë të cënohet e drejta themelore e shtetasve për të votuar dhe mund të cënohen standartet e zgjedhjeve.

9. Të parandalohen incidentet; Të zbatohet me rigorozitet ligji

Tiranë, më 12 Shkurt 2007

Edhe 6 ditë na ndajnë nga zgjedhjet e 18 shkurtit, por incidentet gjatë fushatës elektorale nuk pushojnë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i mendimit se atmosfera e acaruar ka nxitur dhe inkurajuar deri në një farë mase, qoftë edhe indirekt militantizmin ekstrem të personave ose grupeve të veçanta. Në jo pak raste, fushata është shoqëruar dhe me gjuhën e urrejtjes që kandidatë apo përfaqësues të partive politike përdorin ndaj kundërshtarëve të tyre politikë.

Incidentet e ndodhura gjatë fushatës zgjedhore janë bërë pengesë për zhvillimin normal dhe të ligjshëm të propagandës zgjedhore. Grisja dhe heqja arbitrare e posterave, fyerjet dhe kërcënimet ndaj kandidatëve të veçantë, ndërhyrja në aktivitetet e këtij apo atij subjekti, janë fenomene që kërkojnë vlerësim serioz.

KSHH mendon se fushata është pjesë e rëndësishme e procesit zgjedhor që finalizohet ditën e votimit. Në këtë vështrim, incidentet e kësaj natyre në prag të votimit, e tensionojnë situatën dhe mund të ndikojnë negativisht në zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Është kjo arsyeja që KSHH u bën thirrje të gjitha subjekteve që të kontribuojnë në zbutjen e kësaj situatë duke iu përmbajtur Kodit të Sjelljes dhe duke u distancuar e duke dënuar fenomene të tilla që i kundërvihen synimit që në këto zgjedhje të arrihen standartet që kërkohen.

KSHH e shikon të nevojshme gjithashtu t'u bëjë thirrje organeve të depolitizuara të Policisë së Shtetit që në zbatim të detyrave të tyre dhe në përputhje me ligjin, të parandalojnë veprimet që cënojnë rendin dhe të drejtat e shtetasve që provokojnë grindje dhe konflikte. Në raste të tilla, sidomos gjatë fushatës zgjedhore, ndërhyrjet e tyre të shpejta dhe të paanshme janë të domosdoshme.

10. Të respektohet kodi zgjedhor

Tiranë, më 14 Shkurt 2007

Në gazetat "Tema" dhe "Shekulli", të datës 14 shkurt 2007 janë botuar dy lloj sondazhesh. Në të parin z. Olldashi del fitues me 55.1% të votave ndërsa z. Rama me 44.9% të votave. Në të dytin z. Rama si fitues shkon në 60 përqind të votave ndërsa z. Olldashi me 40% të votave.

Të dy publikimet e mësipërme bien ndesh me kërkesat e nenit 134 të Kodit Zgjedhor ku thuhet se “Rezultatet e sondazheve zgjedhore nuk mund të publikohen gjatë 5 ditëve të fundit para datës së zgjedhjeve”, se “Publikimi i rezultateve të sondazheve zgjedhore duhet të përfshijë edhe emrin e organizatorit të sondazhit, porosinë e tij, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit si dhe periudhën e zhvillimit të sondazhit”.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i sugjeron medias së shkruar dhe asaj elektronike që lidhur me sondazhet zgjedhore të respektojnë kërkesat e nenit 134 të Kodit Zgjedhor.

KShH i sugjeron gjithashtu edhe KQZ-së që të ndërhyjë kur vërehen shkelje të Kodit Zgjedhor pavarësisht nga subjekti apo institucioni që nuk respekton dispozitat përkatëse të tij.

11. Ti jepet fund sa më parë procesit të numërimit të votave

Tiranë, më 19 shkurt 2007

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH-ja) mbështetur në informacionet e vëzhguesve të tij dhe në informacionet e herëpashershme që jepen në median elektronike vëren me shqetësim të veçantë se në disa qendra të numërimit të votave është bllokuar ose po vonohet procesi i numërimit të votave.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij momenti dhe faktin që procesi i numërimit të votave është një hallkë e rëndësishme në procesin zgjedhor në Shqipëri, Komiteti Shqiptar i Helsinkit në këtë situatë i bën thirrje Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së) që në përputhje me ligjin të ndërhyjë në mënyrë urgjente, me kompetencë profesionale për të zhblokuar situatën dhe për të kërkuar zbatimin me rigorozitet të ligjin.

Në këtë vështrim KSHH-ja ka parasysh faktin se është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve organi i vetëm Kushtetues që ka për detyrë të mbikqyrë, të drejtojë dhe të verifikojë të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor në Shqipëri. Asnjë organ tjetër nuk mund të marrë atributet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Duke vlerësuar aspektin e numërimit të votave si një halke tejet të rëndësishëm dhe delikat që mund të ketë pasoja për ecurinë e procesit dhe nxjerrjen e rezultateve, KShH-ja shpreh shqetësimin se bllokimi ose zvarritja e nxjerrjes së rezultateve mund të shoqërohet me pasoja të dëmshme.

Edhe njëherë e ritheksojmë se është në kompetencë të KQZ-së të marrë masa për të parandaluar çdo problem dhe të kapërcejë çdo pengesë që ka dalë me kompetencë dhe në frymën e ligjit.

12. Pa reformat të plota zgjedhore nuk mund të arrihen standardet ndërkombëtare

Tiranë, më 30 Mars 2007

Përvoja negative e zgjedhjeve të kaluara, por sidomos e zgjedhjeve të shkurtit 2007, kanë vërtetuar se zvarritjet dhe vonesat e theksuara në përmirësimin e legjislacionit zgjedhor janë shoqëruar me pasoja të dëmshme. Mungesa e vullnetit politik që është shprehje e interesave të ngushta partiake dhe e

mosbesimit midis tyre, e kanë cënuar rëndë procesin zgjedhor dhe imazhin e vendit tonë drejt integritetit evropian.

Është pikërisht kjo arsyeja që KSHH e shikon me vend t'u bëjë thirrje të gjitha partive politike, në radhë të parë dy partive më të mëdha të pozitës dhe opozitës, që me urgjencë të ndërmarrin hapat e nevojshme për plotësimin e reformës zgjedhore.

KSHH mendon se do të ishte gabim dhe e pajustificueshme të pritej shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të 18 shkurtit 2007 dhe raporti i OSBE/ODIHR-it lidhur me to dhe pas kësaj të fillohej nga puna për reformën zgjedhore.

KSHH sugjeron se fillimisht përfaqësuesit e partive politike dhe strukturat parlamentare të diskutojnë dhe të zgjidhnin çështjet e rëndësishme dhe të debatueshme që mund të kërkonin amendime kushtetuese.

KSHH, duke patur parasysh përvojën e mëparshme me aspektet pozitive dhe negative të saj, sugjeron që praktika e hartimit të projekt-ndryshimeve dhe plotësimeve në Kodin Zgjedhor të përfshinte të gjithë gamën e problemeve që përmban ai: zgjedhjet parlamentare dhe ato të qeverisjes vendore si edhe kapitullin mbi referendimet.

KSHH mendon gjithashtu për një punë më të shpejtë dhe më cilësore. Në këtë vështrim, Kuvendi mund të angazhonte një grup specialistësh vendas me përvojë në këtë fushë, jashtë prirjeve dhe ndikimeve partiake, të aftë për hartimin e një projekti që do të përmbante formulime të sakta, të qarta dhe në përputhje me Kushtetutën tonë dhe me dokumentet ndërkombëtare.

KSHH mendon se kryerja me sukses e kësaj detyre, kërkon njohje më të mirë dhe vlerësimin më të drejtë të rekomandimeve të herëpashershme të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias duke patur parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të vendit tonë.

KSHH shpreh bindjen se jo vetëm organizatat jo-fitimprurëse, por edhe grupet e tjera shoqërore, janë të interesuara dhe të gatshme për të dhënë kontributin e tyre modest edhe në fushën e përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit zgjedhor.

KSHH sugjeron që të kalohet në veprime konkrete dhe të lihen mënjanë fjalët dhe deklaratat, me qëllim që nesër të mos jemi të vonuar.

Reforma e mirë zgjedhore kërkon kohën e mjaftueshme dhe ekspertizë.

ANEKS 2

RAPORTET PARAPRAKE TË KSHH-SË TË PUBLIKUARA NË KONFERENCA PËR SHTYP

I. RAPORT MBI RAUNDIN E PARE TË VEZHGIMEVE TË PROCESIT PARAZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET VENDORE, 18 SHKURT 2007

Tiranë, më 13 shkurt 2007

1. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KHH-ja) është angazhuar në vëzhgimin e ecurisë së procesit parazgjedhor në disa zona zgjedhore të bashkive: Tiranë, Gjirokastrë, Fier, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe në komunat e Dropullit, Cepos dhe Odries, Belsh, Cërrik, Shirgjan, Bradashesh, Labinot Fushë, Drenovë, Gjergjan, Spitalë dhe Shkozë.
2. *Objekt i këtij vëzhgimi* ishin: shpallja e listave paraprake dhe përfundimtare në afatin e përcaktuar nga ligji, vendosja e tyre në vende publike, të dukshme dhe të aksesueshme nga zgjedhësit, interesimi i zgjedhësve për listat, ushtrimi i të drejtës së ankesës ndaj parregullsive në lista, vëzhgimi i elementëve të fushatës elektorale, ngritja e komisioneve të qëndrave të votimit dhe trajnimi i anëtarëve të tyre.
3. KSHH-ja është e mendimit se ecuria e procesit zgjedhor në përputhje me ligjin dhe sipas standarteve të kërkuara ndikojnë fuqimisht në ushtrimin e së drejtës së votës dhe në realizimin e zgjedhjeve sipas standartave të kërkuara.
4. *Shpallja e listave paraprake dhe përfundimtare ka paraqitur probleme.* Vonesa në shpalljen e listave varionin nga 5 – 9 ditë dhe deri më datë 30 janar 2007 kishte qëndra votimi ku listat nuk ishin shpallur. Si rrjedhim u reduktua koha e njohjes së zgjedhësve me to dhe si pasojë edhe ankimet tek kryetari i njësive të qeverisjes vendore dhe në gjykatë.
5. Listat përfundimtare nuk janë shpallur në afatin e përcaktuar (8 shkurt 2007) në shumicën e KZQV-ve të vëzhguara. Votuesve u është kufizuar edhe më shumë mundësitë për verifikimin e emrave në liste dhe mundësitë për t'iu drejtuar gjykatës.
6. Në përgjithësi, *vendosja e listave paraprake dhe përfundimtare është bërë në vende të dukshme.* Megjithatë, në disa bashki dhe komuna janë hasur probleme. Në disa zona *listat janë vendosur në ambiente të brendshme* të shkollave, kopshteve, lokale private, posta, etj, të cilat nuk mund të shihen fare gjatë gjithë ditës ose qëndrojnë të mbyllura në pjesën më të madhe të saj, duke i mohuar votuesve të drejtë e verifikimit të emrave në listë. Kjo situatë është hasur në shumë bashki dhe komuna.
7. Ka patur raste që *listat janë shpallur në vende të papërshtatshme* dhe kanë qënë të vështira për tu lexuar për shkak të vendosjes në lartësi dhe distanca të mëdha, me gërma të vogla, aspak të lexueshme dhe të verifikueshme nga zgjedhësit, etj, ose janë *janë vendosur në vende të pambrojtura dhe listat janë grisur.* Në një qëndër të votimit në Fier ishte vendosur si listë paraprake, lista përfundimtare e zgjedhjeve të 3 korrikut 2005. Problem mbetet dhe *ndryshimi i vendeve në të cilat shpallen listat paraprake,* pasi kjo krijon problem pasi shumë qytetarë janë mësuar në vendet e shpalljes së listave të votimit. Në disa raste, pronarët e

lokale private nuk kanë lejuar afishimin e listave për disa arsye, ndër të cilat përmëndet dhe pagesa.

8. *Interesimi i zgjedhësve për listat paraprake ishte tepër i ulët dhe kjo vihej re pothuajse në të gjitha zonat zgjedhore të vëzhguara. Interes më të lartë tregojnë të moshuarit të cilët gjenden përpara listave të votimit të shpallura në vendet e caktuara.*
9. Nga vëzhguesit tanë kemi njoftime se interesimi i zgjedhësve edhe për listat përfundimtare është relativisht i ulët. Arsyet mund të jenë të shumta. Ndoshta ata janë të bindur se emri i tyre figuron në listë. Por nuk përjashtohet edhe mundësia që ata ende nuk janë njohur me procedurat ligjore lidhur me korregjimin e listave.
10. Vonesat në shpalljen e listave paraprake dhe ato përfundimtare janë me pasoja të dëmshme. Deri në ditën e zgjedhjeve mbeten 4-5 ditë. Zgjedhësit duhet të njihen me këto lista dhe po të jetë rasti të ushtrojmë të drejtën e ankimit, ndryshe mund të mbeten pa votuar.
11. *Edukimi ligjor i votuesve dhe sensibilizimi i tyre është i ulët. Megjithë spotet televizive për edukimin zgjedhor të shtetasve të inicuar nga KQZ-ja kanë qënë të vazhdueshme, mendojmë se ai nuk është i kapshëm dhe i kuptueshëm nga të gjithë, sidomos në kushtet e ndryshimit të kodit të zgjedhor dhe të dokumentacionit të votimit. Megjithëse KSHH-ja botoi një numër të konsiderueshëm fletëpalosjesh, suplemente në tre organe shtypi, me gjuhë të thjeshtë për çështjet zgjedhore si dhe kanë dhënë sqarime për aspekte të ndryshme të votimit, mendojmë se veprimtari të tilla janë të pamjaftueshme.*
12. Pothuajse në të gjitha bashkitë dhe komunat e vëzhguara ka persona të cilat ankohen se *nuk kanë gjetur emrat në listat*. Kjo është vënë re më shumë në bashkitë Gjirokastrë Vlorë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë. Megjithatë, shtetasit nuk kanë patur informacionin e duhur për të bërë ankesë – kërkesë te Kryetari i bashkisë ose njësisë vendore ose komunës. Numri i ankesave të rregjistruara ka qënë i ulët në të gjitha bashkitë dhe komunat e vëzhguara. Zgjidhja e tyre në shumicën e rasteve nuk ka patur probleme, pasi kanë qënë ngaterrime në emër ose mbiemër, datëlindja, emri me mbiemrin, etj. Në disa raste është refuzuar dhënia informacioneve rreth numrit të ankesave nga disa njësi bashkiake.
13. Në disa zona janë vënë re që listat përmbajnë emra të shtuar, të personave të vdekur, persona të larguar me banim në qytete të tjera. Kjo u vu re në Komunën e Drenovës - Gjirokastrë, në disa zona të Tiranës, etj. Problem mbetet fakti që persona të të njëjtës familje e gjejnë emrin në qendra votimi të ndryshme. Kjo është vënë re më së shumti në Tiranë dhe në Durrës.
14. Nga vëzhgimet dhe takimet me zgjedhësit, rezulton se mjaft zgjedhës nuk kanë të qartë ndryshimet që janë bërë në Kodin Zgjedhor lidhur me certifikatat e lindjes të lëshuara para dhe mbas datës 1 nëntor 2006. Sipas mendimit tonë, më problematike është procedura që duhet të ndjekin votuesit që kanë certifikata lindjeje të lëshuara para 1 nëntorit 2006. Del nevoja urgjente që media e shkruara dhe elektronike, shoqatat joqeveritare dhe të gjithë ata që janë ngarkuar drejtëpërdrejtë ose jodrejtëpërdrejtë me zgjedhjet t'ua bëjnë të qartë këto çështje votuesve gjatë ditëve të mbetura para ditës së zgjedhjeve. Puna individuale, shtëpi më

shtëpi mund të ishte më e efektshme. Në të kundërtën ditën e zgjedhjeve mund të ndeshemi me raste të papëlqyeshme dhe të palejueshme.

15. Zyrat e gjendjes civile po punojnë me orar të zgjatur. Megjithatë vihen re rradhë të gjata sidomos në Vlorë dhe Korçë.
16. Elementë me rëndësi të fushatës elektorale janë *posterat dhe krijimi i lehtësirave të vendosjes së tyre*. Në përgjithësi posterat janë vendosur jo vetëm në vendet e caktuara nga organet e qeverisjes vendore, por më së shumti në vende të tjera të pamiratuara. Shumë prej tyre, të vendosura në vende të papërshtatshme janë grisur ose janë vendosur postera të një kandidati mbi atë të kandidatit tjetër. Kjo vihet re pothuajse në të gjitha zonat zgjedhore në të cilat është shtrirë vëzhgimi. Vendosja dhe heqja e posterave janë bërë shkak për incidente mes simpatizantëve të forcave politike.
17. KSHH-ja *po vëzhgon fushatën e kandidatëve*. Në përgjithësi në pjesën e dytë të saj ka shpalosje alternativash, por ka edhe gjuhë urrejtjeje, cënim të së drejtës së privatësisë, ka premtime të ekzagjeruara, realizimi i të cilave nuk varet nga organet e qeverisjes vendore. Ka incidente me spotet propagandistike. Ndonëse organet e qeverisjes vendore sipas ligjit caktojnë vendet publike – vendime të tilla duhen respektuar. Ka një tifoza dhe militantizëm të theksuar të cilat e bëjnë situatën zgjedhore konfliktuale. Kandidatën e partive të ndryshme politike kanë përdorur kundërekklamën për fushatën e tyre. Në ndonjë zonë zgjedhore janë rregjistruar raste kur drejtues të institucioneve i kanë ushtruar presion vartëseve të tyre të votojnë për një koalicion të caktuar.
18. Transparenca financiare për fushatën zgjedhore nuk është bërë ende publike. Kemi përshtypjen se fushata shoqërohet me shpenzime të mëdha dhe kandidatën nuk po repsktojnë detyrimin ligjor dhe Kodin e Sjelljes të miratuar prej tyre.
19. *Komisionet zonale të qëndrave të votimit (KZQV-të)* në përgjithësi kanë funksionuar. Por ka prej tyre, ku anëtarët jo në të gjitha rastet ndodheshin në vendin e caktuar të punës.
20. Lidhur me funksionin e tyre ka edhe probleme të tjera shqetësuese që kërkojnë zgjidhje të shpejtë, sidomos në drejtim të zbatimit të ligjit dhe mosbindjes së urdhërave partiake. Një rol tepër të rëndësishëm në kapërcimin e problemeve dhe situata konfliktuale luajnë partitë politike. Nuk duhet nënvlerësuar roli i pazëvendësueshëm i komisioneve zgjedhore që janë të ngarkuara me ligj të administrojnë zgjedhjet. Nëse ato do të paraqesin mangësi profesionale, nëse anëtarët e tyre do të veprojnë si partiake dhe nën diktatin partiak (sic shpesh ka ndodhur në të kaluarën), vështirë të arrihen standartet e kërkuara në zgjedhjet e 18 shkurtit 2007.
21. Dje në datën **12 shkurt 2007**, KQZ-ja dha alarmin: KQV-të që duhet të ngriheshin 10 ditë para datës së zgjedhjeve nuk janë ngritur në pjesën më të madhe të vendit sepse partitë politike nuk kanë paraqitur në KQV-të propozimet përkatëse. Në të gjithë vendin ka 4721 qëndra votimi që do të përbëhen nga 66094 antarë dhe sekretarë të këtyre komisioneve. Ende nuk dihet kur do të ngrihen këto komisione dhe si rrjedhim kur dhe si do të bëhet ose do të arrihet të bëhet trajnimi i tyre.

22. Partitë politike flasin dhe bëjnë deklaratat se zgjedhjet do të zhvillohen në mënyrë të atillë që të arrihen standartet ndërkombëtare. Pavarësisht nga deklaratat e mësipërme, fakti se komisionet bazë të votimit nuk janë ngritur si dhe fakti tjetër se mundësitë për trajnimin e tyre do të jetë mjaft i kufizuar, madje edhe formal nuk mund të mos reflektojë negativisht në arritjen e standarteve. Ndryshimet që iu bënë Kodit Zgjedhor, siç dihet kanë rritur dhe e kanë bërë më delikat rolin e KQV-ve në këtë process zgjedhor.
23. Grupet e numërimit janë gjithashtu një problem tepër i rëndësishëm. Sipas udhëzimit të KQZ-së datë 18.01.2007, subjektet zgjedhore përkatëse duhet të paraqesin propozimet e tyre për këto grupe pune në KQV-të 10 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, ndërsa sot 4 ditë para ditës së zgjedhjeve propozime të tilla nuk janë bërë.
24. Mosngritja e komisioneve të numërit të votave (Sipas ligjit këto grupe duhet të ngrihen 2 ditë para ditës së zgjedhjeve). Afërsisht 35000 persona duhet të identifikohen, verifikohen dhe të trajnohen për të qënë anëtarë të këtyre komisioneve. Mungesa e trajnimit ose trajnimi i shpejtuar, formal cënon arritjen e standarteve. Mjafton të përmendim faktin se antari i grupit të numërimit vec të tjerave duhet të njohë edhe atë pjesë të ligjit ku bëhet fjalë se çfarë konsiderohet fletë votimi e vlefshme dhe çfarë konsiderohet e pavlefshme. Të mos harrojmë se në zgjedhjet e mëparshme numri i fletëvotimeve të pavlefshme ka qënë relativisht i madh.
25. Partitë politike, për arsye të ndryshme, vazhdojnë të tërheqin dhe të zëvendësojnë në KZQV-t anëtarë të propozuar prej tyre. Pasojat e lëvizjeve të tilla janë të dëmshme, pasi zëvendësuesit e anëtarëve mbeten të patrajnuar. Ndaj i bëjmë thirrje partive politike që të veprojnë me seriozitet dhe të vlerësojnë me përgjegjshmëri një situatë të tillë.
26. *Pjesëmarrja në votime* është një moment që duhet të vlerësohet me vemendje të veçantë. Kërkohet një punë e gjit hanshme ndërgjegjësuese. Në këtë drejtim mendojmë se po punohet relativisht pak.
27. Dje në datën 12 shkurt 2007, KSHH-ja e pa të arsyeshme të dalë me një deklaratë publike lidhur me disa incidente që kanë ndodhur gjatë fushatës. Mund të themi vetëm se *incidente të tilla e acarojnë situatën politike dhe* mund të shoqërohen me pasoja të dëmshme. Angazhimi i partive politike dhe ai i forcave të policisë së shtetit mund të kontribuonin në parandalimin e tyre.
28. *Media e shkruar dhe roli i saj në fushata zgjedhore* është i mjaft i rëndësishëm. Nga monitorimi i disa mediave të shkruara gjatë periudhës 20 Janar – 12 Shkurt 2007 ka rezultuar se: gazetat kryesore politike partiake, të pozitës dhe të opozitës përdorin në mënyrë sistematike gjuha e akuzave të urrejtjes. Në artikujt që shkruhen ngrihen në mënyrë të vazhdueshme akuza për mashtrime, korrupsion, vjedhje e shpërdorime të pushtetit ndaj kandidatëve për organet e qeverishjes vendore. Gjuha e urrejtjes është e përqëndruar kryesisht për dy kandidatët kryesorë për Bashkinë e Tiranës.
29. Në kuadër të pasqyrimin të fushatës zgjedhore, gjuha e urrejtjes ka gjetur vend edhe në gazetat jo-politike. Ata pasqyrojnë shqetësimet e vëna re në fushatë, akuzat e ndërsjella mes

kandidatëve, incidentet e ndodhura. Media e shkruar nuk ka i ka kushtuar vemendjen e duhur problemeve me listat.

30. Në prag të afrimit të ditës së zgjedhjeve, *vullneti politik lë shumë për të dëshiruar*. Ai nuk mund të jetë shkopi magjik për zhgjidhjen e çështjeve, por nga ana tjetër, me shkelje të ligjit nuk mund të arrihet ose të kërkohen zgjedhje të lira dhe të ndershme brenda standarteve ndërkombëtare.

II. DISA TË DHËNA PARAPRAKE PËR ECURINË E PROCESIT ZGJEDHOR TË 18 SHKURTIT 2007

KONFERENCA PËR SHTYP 19 SHKURT 2007

Informacione të përgjithshme

1. Pas konferencës së parë për shtyp të Komitetit Shqiptar të Helsinkit lidhur me ecurinë e fushatës zgjedhore sot KSHH-ja del në konferencën e dytë për të paraqitur disa përfundime paraprake lidhur me procesin zgjedhor të zhvilluar dje, më datë 18 shkurt 2007 dhe ecurinë e procesit të numërimit të votave deri në orën 8:00 të ditës së hënë, datë 19 shkurt 2007.
2. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KHH-ja) u angazhua në vëzhgimin e ecurisë së procesit zgjedhor në disa zona zgjedhore të bashkive: Tiranë, Gjirokastrë, Fier, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe në komunat. Gjithsej u angazhuan 150 vëzhgues për procesin e votimit dhe për procesin e numërimit të votave.
3. *Objekt i këtij vëzhgimi* ishin: përgatitja për hapjen e votimit, hapja e qendrave të votimit, respektimi i procedurave të votimit, respektimi i kodit zgjedhor nga komisioneret e qendrave të votimit, gjetja e errave në listë. Votimi i fshehtë, mbyllja e procesit të votimit, dërgimi i kutive në qendër të votimit, numërimi i votave.
4. Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson situatën në përgjithësi të qetë të zhvillimit të procesit të votimit në zonat e vëzhguara prej tij. KSHH-ja shpreh vlerësimet e tija për pjesëmarrjen e votuesve në votime dhe mirëkuptimin e treguar lidhur me vonesat dhe disa probleme të tjera të vëna re në fillimin dhe zhvillimin e procesit të votimit. Megjithë procedurën e komplikuar lidhur me certifikatat e lindjes së lëshuara para dhe pas datës 1 nëntor 2007, verifikimit krahasues së tyre me rregjistrin e posaçëm në përgjithësi zgjedhësit kanë treguar durim dhe mirëkuptim.
5. KSHH-ja vlerëson rolin e policisë para dhe gjatë ditës së votimit, në transferimin e kutive të votimit për në qendrat e numërit të votave dhe gjatë procesit të numërit të votave.
6. Media elektronike ka bërë një mbulim të plotë, të drejtëpërdrejtë të gjithë ecurisë së procesit të votimit dhe problemeve të hasura.

II Procedurat për hapjen e votimit

7. Vëzhguesit e KSHH-së vëzhguan përgatitjet për fillimin e procesit të votimit. Shumë qendra votimi në Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vlorë dhe Fier u hapën me vonesë, pasi baza materiale ka mbëritur me vonesë, në disa qendra votimi ajo ishte e dëmtuar ose e mangët. Ka patur ngatëresa të vulave dhe materialeve të tjera zgjedhore. Për shkak të mungesës së fotokopjeve të rregjistrit të posaçëm, në shumë qendra votimi ato mbritën me vonesë. Në përgjithësi, kutitë e votimit u vulosën me kodet e sigurisë dhe mbahej procesverbal.
8. Në disa qendra votimi kishte më shumë fletë votimi se në numri i zgjedhësve, ndërsa në zona të tjera kishte më pak fletë votimi. Në përgjithësi, komisionet e qendrave të votimit kishin afishuar udhëzimet e votimit në një vend të përshtatshëm. Por kishte qendra votimi në disa zona të Vlorës që nuk ishin hequr materialet propogandistike.
9. Anëtarët e KQV -së dhe përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore jo të gjithë kanë qënë të pranishëm në oren e caktuar për fillimin e përgatitjeve për votim. Kjo është hasur në disa qendra votimi në Tiranë dhe Durrës. Edhe gjatë ditës së votimit ka vazhduar ndërrimi i komisionerëve nga subjektet politike. Mosardhja e autorizimeve të miratimit të tyre ka sjellje vonesa në fillimin e votimit. Gjithashtu, ka patur mungesa të anëtarëve të komisionit; ka patur probleme lidhur me emërimet e komisionerëve në QV në Durrës, Tiranë, Gjirokastrë.
10. Në disa qendra votimi, fletët model në kutitë e votimit ishin të ngjitura gabim dhe kjo sillte konfuzion tek votuesit. Kjo dukuri është hasur më shumë në Tiranë.

III. Procedurat e hapjes së votimit

11. Fillimi i votimit në shumicën e qendrave të votimit është bërë me vonesë, me intervale të ndryshme kohore. Vonesat janë shkaktuar për shkak të ardhjes me vonesë të komisionerëve, por më shumicën e rasteve për shkak të ndarjes jo të plotë të bazës materiale. Në disa zona nuk kishte shkuar rregjistri i posaçëm ose lista e votuesve. Disa nga shkeljet më flagrante të ligjit janë fillimi i votimit pa patur kopjen e procesverbalit të rregjistrit të posaçëm të lëshimit të certifikatave të lindjes janë hasur në një qendër votimi në Elbasan dhe Durrës,
12. *Vonesa e hapjes së qendrave të votimit* ka variur nga ½ në disa orë sidomos në Elbasan Korçë dhe në disa qendra votimi në Tiranë. Fillimi i procesit ka qënë konfuz në shumë zona të vëzhguara. Fillimi i procesit dhe vazhdimi i tij në shumë prej zonave është shoqëruar me debate midis komisionerëve përse i përket dokumentave shtesë të votimit dhe verifikimit të tyre. Në disa qendra votimi të vëzhguara nga ana jonë nuk u zhvilluan zgjedhjet, sidomos më rrethin e Shkodrës.
13. *Votimi familjar*. Edhe në këto zgjedhje pati raste të votimit familjar ose në grup duke cënuar parimin themelor të fshehtësisë së votës. Ky fenomen u re në Elbasan, Cërrik në disa Komuna Elbasanit, në disa qendra votimi të Tiranës etj. Në disa qendra vendodhja e kutive të fshehta cënonte privacinë e votës dhe nuk mundësonte ndriçim të mjaftueshëm. Kishte zgjedhës që ankoheshin për vështirësi në dallimin e emrave të kandidatëve dhe të fletëve të votimit sidomos në Tiranë.

14. Megjithëse kodi zgjedhor ndalon që një anëtarë komisioni ose vëzhgues subjekti të ndihmojë një zgjedhës të votojë, në disa qendra votimi anëtarë të komisionit, por edhe vëzhgues partiakë ndihmonin të moshuarit ose persona të tjerë në kutinë e fshehtë. Kjo dukuri është vënë re në Tiranë dhe në Durrës.
15. *Rregjistri i Posaçëm i certifikatave* dhe përdorimi i tij ishte një shqetësim që u has gjatë ditës së votimit. Sipas nenit 181/2 i kodit zgjedhor, pika 2 jo më vonë se 24 orë para datës së zgjedhjeve, zyra e gjendjes civile i dërgon KZQV-së së njësisë vendore përkatëse kopje të rregjistrit të Posaçëm të vulosur me vulë dhe të nënshkruar nga drejtues të zyrës së gjendjes civile për certifikatat e lëshuara nga çasti i krijimit të regjistrimit të posaçëm të gjendjes civile deri një ditë para datës së zgjedhjeve. Jo më vonë se 12 orë përpara fillimit të votimit, KQZV-të i shpërndanë çdo KQV-je të njësisë përkatëse zgjedhore kopje të vërtetura të lëshuara nga zyra e gjendjes civile. Në fakt, më shumë qendra votimi në Korçë, Elbasan, Tiranë, Durrës, Vlorë, ky rregjistrer mbriti me vonesë dhe pasi qendra e votimit ishte hapur. Edhe përdorimi i tij, shpesh herëshkaktonte konflikte mes kryetarit dhe nënkryetarit për mopërputhje të emrit në dokumente dhe në atë të listës.
16. *Kontrolli i dokumentave të identifikimit të zgjedhësit nuk bëhej në disa zona.* Në disa qendra votimi, sidomos në Durrës është votuar me pasaporte të skaduar duke paraqitur vetëm atë dokumentacion. Pati raste kur disa certifikata nuk u gjenden të rregjistruara në rregjistrin e posaçëm të certifikave dhe megjithatë janë pranuar nga komisioni. Probleme u vunë re edhe në lidhje me penegesat që i nxirreshin votuesve kur ata ishin paisur me certifikata të ditëve të fundit pasi nuk janë rregjistruar në rregjistrin e posaçëm. Lidhur me përdorimin e rregjistrit të posaçëm në disa komisione, komisionerët kishin arritur një konsensus për të lejuar zgjedhësit që të votonin me pasaportë të skaduar. Në disa qendra votimi në Durrës nuk janë lejuar të votojnë me certifikata të marra ditën e votimit, pasi nuk figuronin të rregjistruara dhe se rregjistri ka ardhur në orën 13:00. Në disa qendra votimi të qytetit e Durrësit edhe në Tiranë pati zgjedhës që nuk u pranuan të votonin pavarësisht se kishin certifikatë të lëshuar gjatë ditës së votimit.
17. *Siguria në zgjedhje dhe përdorimi i bojës së ngjyrosur.* Sipas nenit 100, gërma “dh” boja që timbros zgjedhësin nuk duhet të hiqet para 24 orëve. Vëzhguesit në Fier, Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës informuan që në orët e para të votimit se boja fshihej lehtësisht me alkol, aceton dhe me ujë të ngrohtë. Në disa raste zgjedhësve nuk u është vendosur boja në gisht. Kishte raste kur zgjedhësve nuk u kontrollohej dora nëse ishte e ngjyrosur. Sipas ligjit zgjedhësi duhet të firmosë përbri emrit të tij. Ardhja me vonesë e listave të zgjedhësve ka bërë që votuesit e parë të votojnë duke u mbajtur shënim emrat në një letër të bardhë.
18. *Votimi në qytetin e Tiranës kishte vështirësi teknike.* Zgjedhësit ishin paisur me 4 fletë votimi. Kishte paqartësi në disa komisione lidhur me mënyrën e votimit dhe me orientimin e zgjedhësve. Në disa qendra votimi zgjedhësi duke mos e patur të qartë kutinë ku do të hidheshin vletët i kanë hedhur ato jo në kutinë përkatëse.
19. *Votimi i personave me aftësi të kufizuar ose në pamundësi për të votuar* në disa qendra votimi pati probleme. Ligji mundëson votimin nga personat që nuk kanë mundësi të votojnë duke u ndihmuar nga një zgjedhës tjetër, por jo nga anëtarë të komisionit ose vëzhgues të subjekteve

politike ose të pavaruar. Komisioni duhet të mbajë shënim lidhur me raste të tilla dhe se një person nuk mund të ndihmojë më shumë se një zgjedhës. Në fakt në disa qendra votimi, zgjedhës të moshave të vjetra janë lejuar të votojnë bashkë dhe në disa raste janë ndihmuar dhe orientuar nga anëtarë të komisionit të qendrës së votimit. Vëzhguesit kanë pohuar se kishte persona që për arsye fizike kanë patur vështirësi hyrjeje në mjediset e qendrës së votimit.

20. *Listat e zgjedhësve.* Vëzhguesin informuan se pati votues që nuk mundën të votonin pasi nuk gjenin emrin në listë, kishte pasaktësi në regjistrimin e emrit në listë, sidomos në Tiranë. Pothuajse në të gjitha rastet kur konstatoheshin probleme të ndryshme për të cilat komisioni kërkon marrjen e një vendimi ose mbajtjen e një procesverbali, komisionet e qendrave të votimit nuk e kanë bërë këtë gjë.
21. *Votimi i personave të paraburgosur, të dënuarit dhe ushtarakët.* Me marrëveshjen e nëshkruar mes PD-PS, nga Kodi Zgjedhor u hoq çdo dispozitë që kishte të bënte me regjistrin e përkohshëm dhe personat me qëndrim të përkohshëm. Por, pavarësisht nga kjo edhe pa këtë ndryshim sipas neneve 76 të pjesës I, neni 63 pika 2 e Kodit Zgjedhor që nuk kanë ndryshuar del se në zgjedhjen e kandidatëve për kryetar bashkie ose të komunave si dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë ose të komunës marrin pjesë vetëm zgjedhësit me vendbanim në territorin e bashkisë ose të komunës d.m.th. ata që janë të regjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile dhe jo të përkohshmit, se në votimet e organeve të qeverisjes vendore duhen regjistruar në listat e zgjedhësve vetëm ata të dënuar dhe të paraburgosur që kanë vendbanim në njësinë zgjedhore ku ndodhet institucioni. Përsa i përket ushtarakëve, në nenin 107 të Kodit Zgjedhor që nuk është ndryshuar thuhet se në zgjedhjet vendore, zgjedhësit që shërbejnë në forcat e armatosura ose në forcat e rendit votojnë në zonën e qendrës së votimit të vendbanimit të tyre. Ky është një problem që mund të diskutohet në ndryshimet e metejshme që do të behën kodit zgjedhor.
22. *Emigrantët dhe e drejta për të votuar* Është pretenduar që ka emigrantë që përbri emrit të tyre, sipas ligjit nuk është vënë gërma "E". Arsyet mund të jenë të shumta. Kështu psh. koha për verifikim shtëpi për shtëpi nuk ka qënë e mjaftueshme ose dhe për mosvlerësim apo pakujdesi etj. E rëndësishme është që personi që do të votojë (emigrant ose jo) të votojë me dokument identifikimi sipas ligjit (Kodit Zgjedhor të ndryshuar) dhe udhëzimeve të KQZ-së. Kjo është një nga detyrat kryesore të KQV-ve. Në vëzhgimet tona në ato qendra votimi që kemi monitoruar si në Vlorë, Tiranë kishte persona që përbri emrit të tyre gjetën gërmen "E", ndërkohë që nuk ishin emigrantë.
23. *Liria për të votuar.* Procesi i votimit u zhvillua qtesisht pa presione nga kandidatën ose mbështetësit e tyre. Nuk u konstatuan raste të presionit ndaj anëtarëve të KQV-së. Por në disa qendra votimi, për shkak të numrit të madh të komisionerëve, vëzhguesve të subjekteve politike, mjedisëve të vogla dhe zgjedhësve që prisnin të votonin, krijoheshin situatë kaosi dhe rrëmuje.

IV. Procedurat e mbylljes së votimit dhe numërit të votave

24. *Mbyllja e votimit.* Procedurat për mbylljen e qendrave të votimit, pavarësisht se votim në disa prej tyre vazhdoi pas orës 18:00 përfundoi po probleme, me përjashtim të një qendre votimi në

zonën ... Kutitë e votimit dhe kutia me materialet e votimit janë futur në makinë dhe janë shoqëruar për në qendrën e votimit qetësisht dhe kryesisht pa incidente.

25. *Transportimi i kutive të votimit.* Sipas ligjit kutitë e votimit duhet të mbrijnë brenda 3 orëve në vendin e numërimit të votave. Pothuajse në të gjitha vendet e numërimit, kutitë e votimit kanë mbërritur me vonesë, për shkak të pëfundimit me vonesë të procesit të votimit. Marrja në dorëzim e kutive të KQV nga grupet e marrjes në dorëzim është kryer normalisht. Në ndonjë rast, kutitë kishin të vendosura kodet mbrapsht.
26. *Gritja e komisioneve të numërimit të votave dhe fillimi i numërimit.* Koha e fillimit të numërit të votave ka qënë e ndryshme, por në përgjithësi me vonesë, mandje në disa qendra në orët e para të mëngjezit. Ka patur edhe raste kur procesi është ndërprerë për shkak të diskutimeve për raste konkrete. Ngritja me vonesë e komisioneve të numërimit të votave dhe trajnimi i tyre gjatë gjatë ditës së votimit ose edhe natës, pra gjatë kohës kur duhej të bëhej numërimi i votave ndikoi në fillimin me vonesë të numërit të tyre. Në disa raste KQZV-të nuk kishin marre vendime për disa grupe numërimi. Për shkak të kontestimeve dhe moskuptimeve mes anëtarëve të komisioneve të numërimit të votave, mungesës së miratimit të tyre ose mosplotësimit të kritereve që duhet të plotësojë një anëtar komisioni procesit të numërimit ka ecur ngadalë. Procesit të numërimit të votave ka ecur ngadalë. Mes anëtarëve të komisioneve të numërimit kanë lindur kundërshti për çështje teknike ose mosjohjes së ligjit. Ka patur komunikime mes anëtarëve të komisioneve të numërimit të votave dhe përfaqësuesve të subjekteve politikë të pranishëm në këtë proces.

V. Komisionet e votimit

27. Për shkak të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, 36 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe reduktimit të afateve për shumë procese, KZQV-të u ngritën me vonesë. Vonesa u vunë re dhe në ngritjen e KQV ve dhe grupeve të numërimit të votave. Kjo nuk kishte si të mos ndikonte në shkeljen e ligjit. Më datë 17 shkurt 2007 në disa zona zgjedhore nuk ishin ngritur komisionet e qendrave të votimit. Partitë përkatëse nuk kishin çuar emrat në KQZ. Gjithashtu sipas informacioneve të vëzhguesve tanë, nuk ishin ngritur ende komisionet e numërimit të votave, të cilat sipas ligjit duhet të ishin ngritur dy ditë para ditës së votimit. Ngritja me vonesë dhe ndërimi ose zëvendësimi i anëtarëve të QV-së deri në momentin e drekës të ditës së votimit në disa qendra votimi dëmtuan rëndë trajnimin e tyre.
28. KQZV-të, KQV dhe administrimi i procesit të votimit. Anëtarët e komisioneve ishin të patrajnuar ose të trajnuar shomë dobët. Në disa komisione, kishte anëtarë që nuk njohnin procedurat e votimit dhe ligjin. Kishte komisione ku anëtarët përpiqeshin të zgjidhnin çështjet me consensus, pa marrë parasysh kërkesat e ligjit. Në disa raste KQZV-të nuk përgjigjeshin në kohë në zgjidhjen e shqetësimeve ose problemeve që dilnin.

VI. Të ndryshme

29. *Trasparenca finnaciare e fushatës zgjedhore.* Nga fillimi i fushatës dhe deri në datën 16 shkurt 2007, tërheq vëmendjen fakti i shpenzimeve të shumta. Natyrisht nuk është detyra jonë të

llogarisim sa shpenzime janë bërë nga pozita dhe sa nga opozita ose në çfarë mase janë tejkaluar ato në krahasim me sasitë e caktuara nga KQZ-ja. Por duke patur parasysh se edhe në zgjedhjet e mëparshme nuk është bërë transparenca e duhur sic kërkon ligji dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR do të sugjerim që për të parandaluar diskutimet ose akuzat e ndërsjellta të bëhet transparenca e dokumentuar.

30. KShH-ja dhe adresimi i problemeve të votimit

KShH gjatë procesit të votimit por gjithashtu dhe gjatë procesit të numërimit ka bërë ndërhyrjet e saj të nevojshme në KQZ –ë, KZQV -të dhe Komisioneve të qendrave të votimit përkatëse.